DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Nr. 020-660/3
Dat. 12.11.2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Ramiz Lladrovci**, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>**Bekim Lestrani**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së<br>**Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL-së | |
| Nga: | **Erblin Hetemi**, U. d Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 07.11.2024 VI-020-660 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor<br>2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave<br>**Vjosa Ahmetaj**, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave | |
| Lënda: | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Gllogocit | |
| Lloji i aktit: | Akt i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| **Strategjia 02 Nr. 400/01-52944 e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029** |
| I miratuar më datë: 31.10.2024 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.11.2024 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural <u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>.

**Arsyetim**

Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 31.10.2024, ka miratuar Strategjinë 02 Nr. 400/01-52944 e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029.

MAPL, konstaton së akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit, është e harmonizuar me Programin Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal, Udhëzuesin për Hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Modelin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik.

Akti është miratuar në mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Gllogocit me datë 31.10.2024, është miratuar më 19 vota për, 3 kundër dhe 5 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë lidhur me ketë vlerësim.

DALESE - IZLAZNA - OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. 020-660/3 -VI-
Data 12.11.2024

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administartion*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | **Ramiz Lladrovci**, gradonačelnik opštine Glogovac<br>**Bekim Lestrani,** predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Cc:: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS<br>Jedinici za administarciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | **Elbert Krasniqi**, ministar MALS-a,<br>**Jeton Qela**, generalni sekretar MALS-a, | |
| Od: | **Erblin Hetemi**, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS | Dana, 07.11.2024 VI-020-660 |
| Odgovorni službenici:<br>1.Službenik/ca za potvrđivanje pravne procene:<br><br>2.Službenik/ca za izradu pravne ocene | **Xhevat Tafa**, rukovodilac odseka za monitorisanje opština<br><br>**Vjosa Ahmetaj**, viša službenica za monitorisanje opština | |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta opštine Glogovac | |
| Vrsta odluke: | Akt Skupštine opštine Glogovac | |

Poštovani/a gradonačelniče/e,
Poštovani/a predsedavajući/a,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| **Strategija 02 br. 400/01-52944 Lokalnog ekonomskog razvoja 2025-2029** |
| Usvojena dana, 31.10.2024.god |
| Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 04.11.2024.god |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu **u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

**Obrazloženje**

Skupština Opštine Glogovac je na redovnoj sednici održanoj dana, 31.10.2024.godine, odobrila Strategiju 02 br. 400/01-52944 Lokalnog ekonomskog razvoja 2025-2029.

MALS konstatuje da je akt koji je donet od strane Skupštine opštine Glogovac, usklađen sa Nacionalnim programom lokalnog ekonomskog razvoja, Uputstvom o izradi Strategije lokalnog ekonomskog razvoja i Modelom Strategije ekonomskog razvoja.

Akt je usvojen na redovnoj sednici Skupštine opštine Glogovac dana, 31.10.2024. godine, sa 19 glasova za, 3 protiv i 5 uzdržana glasa.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.

**Republika e Kosovës**
Komuna e Drenasit (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës
02 Nr.400101-52944 dt. 31 / 10 / 2024

HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data / Datum / Date: 04.11.2024
Njësia organizative: 01 | Nr. i f. zyrtare: 024-660 | Vlera:

**STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2025 - 2029**

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (" Gaz.Zyrt. e Republikës së Kosovës"), nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit; me nr; 01-110-6904 të dt; 24.09.2008, Dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit, në bazë të nenit nenit 4 paragrafi 2 të Ndryshim Plotësimi i Statutit të Komunës së Drenasit me nr: 12-030-19523 të dt;06.04.2018, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.04/2018 për Transparencën në Komuna, dispozitave të Udhëzimit Administrativ NR.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitave të Rregullores Nr.01/2017 për Procedurat e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, dispozitave të Rregullores (QRK)Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dispozitave të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Gllogoc) në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 31.10.2024, miratoi:

## STRATËGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL 2025-2029

Ky dokument strategjik përcakton objektivat dhe veprimet e planifikuara komunale që duhet të ndërmerren në fushat të ndryshme të ndërlidhura me politikat të cilat adresojnë problemet e caktuara për periudhen kohore 2025-2029.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2025-2029 hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Bekim Lestrani**

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| PRANUAR | 31/10/2024 | | |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 02- | 400101 | 52944 | |


# STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E DRENASIT 2025-2029





Tetor, 2024

## AUTORITETI KONTRAKTUES:

**KOMUNA E DRENASIT**

Rr. "Fehmi lladrovci" nr: 28,
13000 Drenas, Republika e Kosovës
Tel.: 0800 13 050
E-mail: komuna.drenas@rks-gov.net
Web: www.kk.rks-gov.net/drenas

## OPERATORI EKONOMIK

**D&D BUSINESS SUPPORT CENTER**

Rr. "Xheladin Hana", Ndërtesa Iliria,
10000 Prishtina, Republika e Kosovës
Tel.: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564
E-mail: info@dd-bsc.com
Web: www.dd-bsc.com

## Tabela e Përmbajtjes

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës....7
1. Përmbledhja ekzekutive....8
2. Hyrja....9
3. Metodologjia....11
4. Misioni....12
5. Vizioni....12
6. Sfondi dhe analiza e gjendjes....13
6.1. Historiku dhe shtrirja gjeografike....13
6.2. Demografia e Komunës....15
6.3. Administrimi i Komunës....17
6.4. Ekonomia dhe punësimi....19
6.4.1. Zonat Ekonomike në Drenas....20
6.4.2. Bizneset sipas llojit të regjistrimit....20
6.4.3. Tregtia....21
6.4.4. Prodhimtaria dhe Përpunimi....22
6.4.5. Sfidat e sektorit privat në Drenas....23
6.4.6. Gjendja e punësimit....23
6.5. Arsimi....25
6.5.1. Menaxhimi i arsimit dhe administratës në arsim....26
6.5.2. Sigurimi i Cilësisë....26
6.6. Infrastruktura....28
6.6.1. Infrastruktura publike....28
6.6.2. Infrastruktura hekurudhore....28
6.6.3. Menaxhimi i Mbeturinave në Komunën e Drenasit....29
6.6.4. Ujësjellësi....29
6.6.5. Kanalizimi fekal....30
6.6.6. Energjetika....31
6.6.7. Telekomunikacioni....31
6.6.8. Hapësirat publike (Parqet dhe Sheshet)....31
6.7. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale....31
6.8. Gjendja e bujqësisë në Komunën e Drenasit....33
6.8.1. Sektori i prodhimit bimorë....35
6.8.2. Sektori i Bletarisë....36
6.8.3. Sektori i Blegtorisë....37

6.9. Turizmi dhe trashëgimia kulturore, rinia dhe sporti ... 38
6.9.1. Turizmi ... 38
6.9.2. Kultura dhe sporti ... 39
6.9.3. Rinia ... 42
6.10. SWOT analiza ... 43
6.11. Analiza e situatës ... 44
6.12. Përmbledhja e sfidave ... 45
6.12.1. Sfidat në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ... 45
6.12.2. Sfidat në sektorin e Arsimit ... 46
6.12.3. Sfidat në sektorin e Infrastrukturës ... 47
6.12.4. Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale: ... 47
6.12.5. Sfidat në sektorin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore ... 48
7. Objektivat ... 49
7.1. Objektiva e Përgjithshme 1: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik lokal dhe infrastrukturës 49
7.1.1. Objektiva specifike 1.1. : Diversifikimi Ekonomik ... 49
7.1.2. Objektiva specifike 1.2.Tërheqja e investimeve të reja, dhe rritja e punësimit ... 49
7.1.3. Objektiva specifike 1.3. Zhvillimi i ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion ... 49
7.1.4. Objektiva specifike 1.4. Krijimi i infrastrukturës për mbështetje të zhvillimit te qëndrueshëm socio/ekonomik ... 50
7.2. Objektiva e përgjithshme 2: Shëndetësia dhe mirëqenia sociale - Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale për të gjithë banorët ... 50
7.2.1. Objektiva specifike 2.1. : Zgjerimi i Shërbimeve Mjekësore dhe Sociale ... 50
7.2.2. Objektiva specifike 2.2.: Përmirësimi i Infrastrukturës Shëndetësore dhe Sociale ... 51
7.2.3. Objektiva specifike 2.3. : Forcimi i Kapaciteteve të Personelit Shëndetësor dhe Social 51
7.3. Objektiva e përgjithshme 3: Përmirësimi i cilësisë së arsimit ... 52
7.3.1. Objektiva specifike 3.1.: Modernizimi i infrastrukturës dhe pajisja me teknologji të avancuar ... 52
7.4. Objektiva e përgjithshme 4: Rritja e Prodhimit Bujqësor ... 53
7.4.1. Objektiva specifike 4.1. Diversifikimi i prodhimtarisë bujqësore ... 53
7.4.2. Objektiva specifike 4.2. Rritja e zingjirit të vlerës së produkteve bujqësore ... 53
7.4.3. Objektiva specifike 4.3. Zgjerimi i sipërfaqeve nën ujitje ... 54
7.5. Objektiva e Përgjithshme 5: Zhvillimi i kapaciteteve lokale në sektorin e turizmit ... 54

7.5.1. Objektiva specifike 5.1.: Inventarizimi dhe klasifikimi i resurseve turistike, elemente të produkteve turistike, si dhe zhvillimi i produkteve më premtuese turistike ........ 54
8. Burimet e Financimit ........ 55
8.1. Financimet publike lokale ........ 55
8.2. Financimet tjera ........ 55
9. Monitorimi dhe Raportimi ........ 55
10. Plani i Veprimit ........ 57
Burimi i financimit (nëse financohet nga komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatori duhet të cket) ........ 79

## Lista e figurave

Figura 1. Popullsia sipas gjinisë dhe grup moshës në % ........ 15
Figura 2. Administrata e Komunës së Drenasit ........ 18
Figura 3. Bizneset sipas llojit të regjistrimit (Qendra e regjistrimit të bizneseve në Drenas) ........ 20
Figura 4. Bizneset tregtare ........ 22
Figura 5. Bizneset prodhuese dhe përpunuese ........ 22

## Lista e tabelave

Tabela 1. Vendbanimet në komunë, 2018 (Popullsia është nga Regjistrimi 2011) ........ 16
Tabela 2. Personeli i Komunës sipas drejtorive ........ 19
Tabela 3. Numri i bizneseve sipas veprimtarisë ........ 20
Tabela 4. Punëkërkues të regjistruar sipas regjioneve ........ 24
Tabela 5. Numri i personelit ne QKMF ........ 32
Tabela 6. Institucionet shëndetësore, vendi, gjendja e objektit dhe inventari ........ 32
Tabela 7. Aplikuesit tre vitet e fundit (2022,2023,2024) ........ 35
Tabela 8. Aplikuesit tre vitet e fundit (2022,2023,2024) ........ 37
Tabela 9. OJQ-të Rinore ........ 40
Tabela 10. Aktivitetet e mbajtura në sallën e Kulturës ........ 40
Tabela 11. OJQ-të - Klubet, Shoqatat Sportive të Regjistruara në MAP dhe DKRS - AKTIVE 2023 ........ 40
Tabela 12. Panairet dhe festivalet tradicionale ........ 41
Tabela 13. Plani buxhetor 2025 - 2027 ........ 55

## Grupi punues për hartimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik

Anëtarët e Ekipit Komunal për Hartimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal për periudhën afatmesme 2025-2029 janë:

1. Agnesë Kastrati Bucolli – Kryesuese e Grupit Punues
2. Afrora Kajtazi Sinani – Zëvendës kryesuese e Grupit Punues
3. Shehrie Mustafa- Kordinatore
4. Blerim Nika – Anëtarë
5. Kimete Qorri – Anëtare
6. Lumturije Kiqina – Anëtare
7. Laura Vrellaku Pasjaqa – Anëtare
8. Kajtaz Kastrati – Anëtarë
9. Shaban Dobra – Anëtarë
10. Besart Bajrami – Anëtarë
11. Vlora Gjinofci – Anëtare
12. Safet Hoxha – Anëtarë
13. Naxhije Leci Hajdari – Anëtare
14. Afrim Prokshi – Anëtarë
15. Bekim Dobra – Anëtarë
16. Zyrafete Nishori – Anëtare
17. Shqipe Hoxha – Anëtare nga Organizatat e Shoqërisë Civile
18. Habib Janova – Anëtarë/Përfaqësues i bizneseve

## Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë,



Qeverisja Komunale e Drenasit mbetet e përkushtuar që në vazhdimësi të punojë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Duke investuar në projekte që mbulojnë fusha të rëndësishme si infrastruktura, bujqësia, arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale dhe kultura e rinia, ne synojmë të krijojmë mundësi të reja për qytetarët dhe bizneset. Një nga vlerat kyçe të qeverisjes sonë është transparenca dhe llogaridhënia, duke u siguruar që qytetarët të jenë të informuar dhe të përfshirë në proceset vendimmarrëse. Ne besojmë se përgjegjësia institucionale ndërton besim dhe ndihmon në përmirësimin e shërbimeve për të gjithë.

Në strategjinë tonë për zhvillim ekonomik lokal, për periudhën 2025-2029, kemi përcaktuar tre objektiva kyçe:

1. Përmirësimin e vazhdueshëm të ambientit për sektorin privat dhe nxitjen e zhvillimit të pandalshëm të ndërmarrjeve dhe ekonomisë lokale.
2. Fuqizimin e qytetarëve përmes pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe për të përfituar nga zhvillimet në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale.
3. Përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies, bazuar në praktikat më të mira të qeverisjes lokale.

Drenasi është ndër komunat që shquhet për një qasje të hapur dhe të drejtpërdrejtë me qytetarët. Në këtë kontekst, ne do të vazhdojmë të publikojmë raportet e detajuara të projekteve dhe rezultateve, duke rritur pjesëmarrjen qytetare dhe duke forcuar besimin në institucionet tona.

Besoj fuqishëm se ky dokument strategjik do të jetë një udhërrëfyes për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe për krijimin e mundësive të reja për të gjithë.

Me respekt,
Ramiz Lladrovci
Kryetar i Komunës së Drenasit

## 1. Përmbledhja ekzekutive

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal e Komunës së Drenasit synon të transformojë ekonominë lokale dhe të rrisë mirëqenien e qytetarëve të saj. Kjo nënkupton krijimin e kushteve të favorshme për bizneset, përmirësimin e infrastrukturës, arsimit, shërbimeve shëndetësore dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, që do të jenë shtyllat kryesore për arritjen e këtyre synimeve.

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Drenasit synon të krijojë një mjedis miqësor për bizneset si dhe fuqizimin e sektorit të shërbimeve dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Objektiva kryesore është krijimi i një mjedisi ekonomik që mbështet investimet, krijimin e vendeve të reja të punës, ruajtjen e mjedisit jetësor dhe përmirësimin e mirëqenies së banorëve.

Objektivat e përgjithshme për zhvillimin e Komunës së Drenasit për 5 vitet e ardhshme përfshijnë disa fusha kyçe që synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin ekonomik të kësaj komune:

1. **Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal:** Strategjia synon që përmes diversifikimit ekonomik, tërheqjes së investimeve të reja dhe zhvillimin e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion, përmirësim të infrastrukturës, të ndikoj në rritjen e punësimit dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Drenasit.
2. **Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale:** Zgjerimi i shërbimeve mjekësore dhe sociale, përmirësimi i infrastrukturës shëndetësore, forcimi i kapaciteteve të personelit shëndetësor dhe social, për të pasur mundësi që të ofrohen shërbime bashkëkohore në këto fusha.
3. **Përmirësimi i cilësisë në arsim:** Rritja e përfshirjes së barabartë për të gjithë nxënësit, për të përgatitur më mirë brezat e ardhshëm për sfidat e tregut të punës dhe shoqërisë. Modernizimi i infrastrukturës dhe pajisja me teknologji të avancuar krahas zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale dhe rritja e përfshirjes së komunitetit dhe familjes në arsim.
4. **Rritja e prodhimit bujqësor:** Diversifikimi i prodhimtarisë bujqësore përmes rritjes së sipërfaqeve, të llojllojshmërisë dhe zingjirit të vlerës së prodhimeve bujqësore. Riaktivizimi i sistemeve ekzistuese të ujitjes dhe zgjerimi i sipërfaqeve nën ujitje.
5. **Nxitja e zhvillimit të sektorit të shërbimeve, turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe historike:** Përkrahja për zhvillimin e turizmit rural dhe agroturizmit, aktiviteteve tradicionale, panaireve dhe aktiviteteve që tërheqin turistë dhe nxjerrin në pah traditat dhe kulturën lokale. Ndërtimi i hapësirave të dedikuara për ekspozita dhe organizime tjera që tregojnë historinë dhe trashëgiminë kulturore të komunës, duke përfshirë ekspozita me artefakte historike, fotografi dhe dokumente.

## 2. Hyrja

**Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Drenasit 2025-2029** synon të krijojë një vizion të qartë dhe të jetë një udhëzues për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të saj, për periudhën e ardhshme pesëvjeçare. E ndërtuar duke shfrytëzuar shumë burime dhe me një gjithëpërfshirje të të gjithë akterëve relevantë, përfshirjes sociale dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe njerëzore, kjo strategji përfaqëson një qasje të integruar për të përballuar sfidat ekonomike të kohës dhe për të shfrytëzuar sa më mirë potencialet që ka komuna e Drenasit.

Nëpërmjet këtij dokumenti, komuna e Drenasit do të përqendrohet në zhvillimin e disa sektorëve kryesorë ekonomikë, si sektori privat, bujqësia, shërbimet, duke krijuar një ambient të favorshëm për investime dhe inovacion. Po ashtu, strategjia i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe zhvillimit të qëndrueshëm, me synimin për të ngritur nivelin e jetesës dhe për të përmirësuar infrastrukturën publike.

Pjesa e objektivave dhe planit të veprimit, jep një vizion që garanton zhvillim të barabartë, duke promovuar barazinë gjinore, përfshirjen e grupeve të margjinalizuara dhe përmirësimin e qasjes në arsim, shëndetësi, shërbime sociale dhe infrastrukturë.

Kjo strategji përfaqëson angazhimin e përbashkët të autoriteteve lokale dhe komunitetit për të ndërtuar një të ardhme të sigurt dhe të qëndrueshme për Komunën e Drenasit.

Hartimi i Strategjisë është udhëhequr nga Grupi Punues i themeluar nga Kryetari i Komunës, i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha drejtorive, përfaqësues të biznesit, shoqërisë civile, duke përfshirë edhe profesionistë nga fusha të ndryshme me rëndësi për Komunën e Drenasit.

Hartimi i strategjisë është përkrahur nga Kompania Konsulente "D&D Business Support Center" me seli në Prishtinë që ka ndihmuar në strukturimin dhe hartimin e strategjisë. Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron që strategjia të jetë e mirë menduar dhe të përfshijë nevojat dhe aspiratat e të gjitha grupeve të interesit në komunë.

Për hartimin e strategjisë janë shfrytëzuar dokumente të ndryshme relevante, si: ligje që mbulojnë zhvillimin ekonomik lokal, strategji të ndryshme në nivel vendi, strategji sektoriale të Komunës së Drenasit dhe burime të tjera.

Dokumentet dhe strategjitë më relevante që janë konsultuar:

**Plani Kombëtar i Zhvillimit 2030** është një dokument strategjik që përcakton vizionin, prioritetet dhe objektivat e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor të Republikës së Kosovës deri në vitin 2030. Ky plan synon të krijojë një bazë për rritje të qëndrueshme, përmirësim të mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillim të përgjithshëm të vendit.

**Strategjia për Vetëqeverisje Lokale e Republikës së Kosovës 2016-2026** është një dokument i rëndësishëm strategjik, i cili synon të forcojë vetëqeverisjen lokale dhe të përmirësojë ofrimin e shërbimeve publike në nivelin komunal. Kjo strategji synon të rrisë autonominë e komunave, të forcojë kapacitetet institucionale dhe të sigurojë një qeverisje më të përgjegjshme dhe transparente.

**Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2030** synon të përmirësojë zhvillimin ekonomik në nivel lokal në Republikën e Kosovës, duke u përqendruar në rritjen e kapaciteteve të komunave për të krijuar mjedise të favorshme për investime dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Ky program përcakton politika dhe masa që do të zbatohen në periudhën 2024-2030 për të rritur konkurrencën lokale, zhvillimin e bizneseve dhe përmirësimin e infrastrukturës lokale.

**Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-2026** është një planifikim buxhetor afatmesëm i Republikës së Kosovës që përcakton kornizat kryesore për alokimin dhe menaxhimin e burimeve financiare për periudhën 2024-2026. KASH është një instrument thelbësor për përcaktimin e prioriteteve të qeverisë dhe garantimin e një përdorimi efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve publike. Kjo kornizë ndihmon në lidhjen e politikave zhvillimore me realitetin buxhetor, duke ndihmuar vendimmarrësit të planifikojnë në mënyrë strategjike.

Janë konsultuar edhe ligjet relevante që rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me vetëqeverisjen lokale dhe zhvillimin ekonomik lokal, siç janë:

- Ligji për Financat e Pushtetit Lokal NR. 03/L-049, 2008.
- Ligji Nr. 04/L-045 Për Partneritete Publike Private.
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale/NR. 03/L-040.
- Statuti i Komunës së Lipjanit Nr.110-78095, 24.01.2021.
- Ligji nr. 06/l-092 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

## 3. Metodologjia

Hartimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës së Drenasit për periudhën 2025-2029 është realizuar me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe duke përfillur e zbatuar udhëzimet e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, të dhëna në udhëzimin për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal.

Hapi i parë ka qenë formimi i grupit punues, i themeluar nga ana e Kryetarit të Komunës. Përveç tri takimeve të grupit punues, në fillim janë mbajtur takime informuese me të gjitha drejtoritë e Komunës, ku janë diskutuar në hollësi situata aktuale dhe sfidat që ka çdo sektor veçmas për zhvillimin e ardhshëm.

Analiza gjithëpërfshirëse e situatës ekzistuese ekonomike është realizuar duke përfshirë sektorët kryesorë të ekonomisë: bujqësia, industria, arsimi, shëndetësia dhe mirëqenia sociale, infrastruktura, shërbimet publike, rinia, turizmi dhe trashëgimia kulturore. Janë identifikuar burimet kryesore ekonomike, potencialet dhe sfidat ekzistuese

Gjatë kësaj kohe është bërë grumbullimi dhe analiza e të dhënave statistikore për tregun e punës, investimet, burimet natyrore, infrastrukturën, si dhe indikatorët socialë dhe demografikë.

Gjithashtu, në këtë fazë janë analizuar edhe dokumentet ekzistuese, si plani zhvillimor komunal dhe dokumentet e strategjitë e nivelit qendror që lidhen me zhvillimin ekonomik lokal dhe legjislacionin përkatës.

Duke u bazuar në qasjen gjithëpërfshirëse dhe të dhënat e sakta nga analizat strategjike, kjo strategji do të jetë një bazë e fortë për të siguruar suksesin afatgjatë të zhvillimit ekonomik lokal në Komunën e Drenasit.

## 4. Misioni

Në përputhje me parimet e qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme, komuna e Drenasit do të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shërbime publike efikase e cilësore, duke përfshirë përmirësimin e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Përmes një bashkëpunimi të ngushtë me komunitetin dhe sektorin privat, komuna do të zhvillojë një mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm, duke përfituar nga burimet natyrore dhe kulturore, dhe duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, për të siguruar një cilësi më të lartë të jetës dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

## 5. Vizioni

Të bëhet një komunë e zhvilluar me ekonomi të qëndrueshme, infrastrukturë moderne, shërbime publike efikase dhe cilësi të lartë të jetës për të gjithë qytetarët.

## 6. Sfondi dhe analiza e gjendjes

### 6.1. Historiku dhe shtrirja gjeografike

Komuna e Drenasit u krijua para Luftës së Dytë Botërore si një njësi e veçantë sociale, politike dhe administrative. Deri në vitet e pas luftës së fundit, zhvillimi ekonomik ishte i ngadalshëm, kryesisht për shkak të përkrahjes së pamjaftueshme nga nivelet qendrore. Përpjekjet e para për një zhvillim më të hovshëm të komunës, filluan në vitet '70 të shekullit të kaluar. Në vitin 1981, Drenasi fitoi statusin e qytetit, duke u bërë një qendër kryesore administrative, kulturore dhe sociale për komunën [1].

Komuna ka ndërmarrë hapa drejt një transformimi të ngadaltë, por të qëndrueshëm, në sektorët ekonomik, bujqësor, arsimor, shëndetësor dhe industrial. Një ndryshim i rëndësishëm ekonomik ndodhi me ndërtimin e kompleksit industrial "Feronikeli" në vitin 1984, që kontribuoi në përmirësimin e ekonomisë lokale dhe afroi Drenasin me mesataren e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Pas luftës së fundit, kushtet për zhvillimin e përgjithshëm të komunës ndryshuan rrënjësisht në mënyrë mjaft të favorshme. Këto ndryshime i kanë mundësuar komunës përmirësime substanciale në të gjitha aspektet e zhvillimit, përfshirë ekonominë, industrinë dhe infrastrukturën urbane e rurale, për të plotësuar nevojat e së ardhmes.

**Territori i komunës së Drenasit** shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në luginën e Drenicës, 32 km nga Prishtina. Ai shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe atij të Dukagjinit, duke shërbyer si një urë lidhëse midis këtyre dy rajoneve.

Komuna e Drenasit ka një sipërfaqe prej 275,63 $km^2$, me një lartësi mbidetare që varion nga 575 m në pikën më të ulët deri në 1072 m në pikën më të lartë.

Komuna e Drenasit rrethohet nga Malet e Berishës në pjesën jugperëndimore, të Kosmaqit në perëndim, të Qyqavicës në veri dhe Goleshit e Lipovicës (Blinajës) në juglindje. Këto male shtrihen në të dy anët e luginës së lumit Drenica. Sa i përket komunave fqinje, në veri kufizohet me Komunën e Skënderajt, në verilindje me atë të Vushtrrisë, në lindje me komunën e Obiliqit dhe Fushë Kosovës, në juglindje me Lipjanin, në jugperëndim me komunën e Malishevës dhe në perëndim me atë të Klinës.

[1] PZHK


POZITA FIZIKO-GJEOGRAFIKE E KOMUNËS SË DRENASIT
4 0 4 8 12 km
LEGJENDA
Vendbanimet
Rrugë Nacionale
Zonat Kadastrale
Komunat Fqinjë
Rrugë Rajonale
Rrugë Autouchë
Kufiri i Komunës
Punoi:
Msc.Besort Bajrami
Zyrar I Lartë për GIS
Komuna e Drenasit

Komuna e Drenasit ka klimë të mesme kontinentale, me dimra të ftohtë dhe verëra të ngrohta. Temperatura mesatare vjetore është 10.6°C, ku muaji më i ftohtë është janari me 0.8°C, ndërsa muaji më i ngrohtë është korriku me 20.6°C. Sasia mesatare e të reshurave është rreth 670 mm në vit, ndërsa lartësia mbidetare varion nga 500 deri në 650 m. Afërsisht gjysma e territorit të Komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare prej rreth 650 m, lartësi kjo mjaft e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë.

### 6.2. Demografia e Komunës

Në bazë të vlerësimit të popullsisë të realizuar në vitin 2011, rezulton që numri i popullsisë në Komunën e Drenasit ka qenë 58,531 banorë, nga të cilët 51% i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 49% gjinisë femërore.

Figura 1. Popullsia sipas gjinisë dhe grupmoshës në %




Në bazë të grafikut të paraqitur më lart, mosha e re 0-14 vjeç përbën 29.5% të popullsisë së Drenasit, kategoria e grupmoshës 15-64 vjeç merr pjesë me 64.8%, kurse mosha mbi 65 vjeç me rreth 5.6% të popullsisë së përgjithshme. Nga kjo që u tha më lart, mund të vijmë në përfundim se grupmosha e popullsisë 15-64 vjeç dominon në popullatën e përgjithshme.

Shumica e lindjeve kryhen në QKUK në Prishtinë. Ndërsa lindjet që kanë ndodhur në maternitetin e Komunës në vitin 2022 janë gjithsej 9 (nëntë), prej tyre 5 (pesë) meshkuj dhe 4 (katër) femra. Kurse në vitin 2023 kanë ndodhur 3 (tri) lindje, ku 1 (një) është i gjinisë mashkullore dhe 2 (dy) janë të gjinisë femërore.

Madhësia e familjes – Madhësia mesatare e familjes në qytet rezulton të jetë më e vogël se në vendbanimet tjera në komunë. Në qytet, familjet mesatarisht kanë nga 5.9 anëtarë, ndërsa në nivel të komunës kanë nga 6.7 anëtarë.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, dendësia e popullsisë në Komunën e Drenasit është rreth 212 banorë për km², që është mbi mesataren kombëtare prej 165 banorësh për km². Në disa vendbanime me numër më të madh të popullsisë, edhe dendësia është shumë më e lartë dhe, e kundërta, në vendbanimet me numër të vogël të popullsisë, dendësia është shumë më e ulët.

Dendësia më e lartë e popullsisë është në qytetin e Drenasit, ku mesatarisht jetojnë rreth 1651 banorë për km². Dendësitë në vendbanime të tjera janë: Komoran (389.5 banorë/km²), Çikatovë e Re (363.1 banorë/km²), Nekoc (301.3 banorë/km²), Gllabar (300.4 banorë/km²), etj. Ndërsa vendbanimet me shkallë më të ulët të dendësisë së popullsisë janë: Vasilevë (65.7 banorë/km²), Gradicë (68.7 banorë/km²) dhe Vuçak (80.4 banorë/km²).

**Tabela 1.** Vendbanimet në Komunë, 2018 (Popullsia është nga Regjistrimi 2011)

| Vendbanimet | Tipi (Urban/ Rural) | Banorë (nr.) | Sipërfaqe (km²) | Dendësia (nr./km²) |
|---|---|---|---|---|
| Abri e Epërme | Rural | 1776 | 12.10 | 146.77 |
| Arllat | Rural | 3134 | 13.13 | 238.78 |
| Baicë | Rural | 2307 | 11.51 | 200.40 |
| Çikatovë e Re | Rural | 2026 | 5.59 | 362.53 |
| Çikatovë e Vjetër | Rural | 1261 | 6.67 | 189.05 |
| Dobroshec | Rural | 1457 | 13.03 | 111.79 |
| Domanek | Rural | 706 | 3.14 | 224.74 |
| Fushticë e Epërme | Rural | 984 | 4.56 | 215.79 |
| Fushticë e Ulët | Rural | 1066 | 6.14 | 173.74 |
| Gllabar | Rural | 1526 | 5.09 | 299.90 |
| Gllanasellë | Rural | 1591 | 10.59 | 150.22 |
| Drenas | Urban | 6143 | 3.72 | 1650.28 |
| Godanc | Rural | 358 | 3.72 | 96.27 |
| Gradicë | Rural | 842 | 12.26 | 68.67 |
| Kishnarekë | Rural | 1504 | 6.60 | 227.71 |
| Komoran | Rural | 4393 | 11.29 | 389.04 |
| Korroticë e Epërme | Rural | 1240 | 8.50 | 145.97 |
| Korroticë e Ulët | Rural | 972 | 4.13 | 235.56 |
| Krajkovë | Rural | 1181 | 7.49 | 157.75 |
| Likoshan | Rural | 600 | 4.56 | 131.45 |
| Llapushnik | Rural | 3433 | 15.24 | 225.21 |
| Negroc | Rural | 1540 | 10.08 | 152.84 |
| Nekoc | Rural | 3118 | 10.36 | 300.87 |
| Poklek | Rural | 1967 | 6.98 | 281.88 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Polluzhë** | Rural | 1017 | 4.18 | 243.11 |
| **Sankoc** | Rural | 1437 | 13.98 | 102.78 |
| **Shtrubullovë** | Rural | 1102 | 2.79 | 394.49 |
| **Shtuticë** | Rural | 934 | 4.63 | 201.52 |
| **Tërdec** | Rural | 1121 | 8.40 | 133.41 |
| **Tërstenik** | Rural | 3903 | 15.63 | 249.79 |
| **Vasilevë** | Rural | 634 | 9.66 | 65.61 |
| **Vërboc** | Rural | 1247 | 8.00 | 155.89 |
| **Vuçak** | Rural | 369 | 4.59 | 80.40 |
| **Zabel i Epërm** | Rural | 565 | 4.52 | 125.06 |
| **Zabel i Ulët** | Rural | 1077 | 3.12 | 345.05 |
| | | 58531 | 275.99 | |

### 6.3. Administrimi i Komunës

Administrata e Komunës së Drenasit është e organizuar në 11 drejtori, të cilat përfshijnë sektorë të ndryshëm sipas fushave. Gjithashtu, kabineti i Kryetarit të Komunës ka 7 zyra të ndryshme që ndihmojnë në punën e kryetarit dhe administratës komunale.

Për më shumë detaje, shihni Figurën 2.

Figura 2. Administrata e Komunës së Drenasit



Në administratën komunale janë të punësuar gjithsej 181 zyrtarë, duke përfshirë edhe stafin politik dhe zjarrfikësit.

Nga ky total, 80 prej tyre janë gra, ndërsa 17 janë persona me nevoja të veçanta.

Numri i përgjithshëm i zyrtarëve të emëruar në pozita politike është 19, prej të cilëve disa janë gra.

Tabela 2. Personeli i Komunës sipas drejtorive

| Drejtoritë | Personeli | Gjinia | |
|---|---|---|---|
| | | M | F |
| Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik | 8 | 0 | 8 |
| Inspektoriati | 9 | 7 | 2 |
| Arsim | 11 | 6 | 5 |
| Bujqësi | 5 | 2 | 3 |
| Buxhet dhe Financa | 16 | 8 | 8 |
| Shërbime Publike dhe Emergjencë | 24 | 21 | 3 |
| Administrata e Përgjithshme | 40 | 19 | 21 |
| Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale | 18 | 8 | 10 |
| Infrastrukturë Publike | 6 | 4 | 2 |
| Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | 8 | 3 | 5 |
| Kulturë, Rini dhe Sport | 13 | 9 | 4 |
| Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë | 8 | 5 | 3 |
| Zyra e Kryetarit | 15 | 9 | 6 |
| Gjithsej | 181 | 101 | 80 |

### 6.4. Ekonomia dhe punësimi

Zhvillimi i sektorit privat në Komunën e Drenasit, veçanërisht i Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM), ka qenë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal, sidomos në krijimin e vendeve të punës. Ky sektor kryesisht është përkrahur nga donatorët e ndryshëm, ndërsa komuna kryesisht ka ndikuar në ofrimin e lehtësirave të ndryshme për to. Natyrisht, krijimi dhe funksionalizimi i Parkut të Biznesit ka ndikuar në rritjen e investimeve vendore dhe të huaja, duke kontribuar gjithashtu në krijimin e vendeve të reja të punës.

### 6.4.1. Zonat Ekonomike në Drenas

Zona Industriale në Drenas shtrihet në km-n e 16-të të rrugës Prishtinë - Pejë dhe gjendet përballë Parkut të Biznesit në Drenas, të cilat në të ardhmen do të paraqesin një njësi të integruar.
Zona do të ofrojë sipërfaqe toke nën infrastrukturë, plan rregullativ dhe urbanistik. Menaxhimi i Zonës do të jetë konform Ligjit mbi Zonat Ekonomike.

Parku i Biznesit në Drenas (PBD) gjendet në fshatin Korreticë e Epërme të Drenasit dhe shtrihet në km-n e 16-të përgjatë magjistrales Prishtinë – Pejë, duke përfshirë një sipërfaqe prej 24 ha të ndarë në 56 njësi të madhësive të ndryshme: 43 parcela me sipërfaqe deri në 3000 $m^2$, 7 parcela me sipërfaqe prej 3000 deri në 6000 $m^2$ dhe 6 parcela me sipërfaqe mbi 6000 $m^2$. Kjo është një sipërfaqe toke e ndarë nga komuna e Drenasit dhe e financuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

### 6.4.2. Bizneset sipas llojit të regjistrimit

Deri në fund të vitit 2023, në Komunën e Drenasit janë të regjistruara 2314 biznese aktive, prej të cilave 1470 apo 63.4% janë biznese individuale, ndërsa 844 apo 36.6% janë biznese SHPK dhe të tjera.

Figura 3. Bizneset sipas llojit të regjistrimit (Qendra e regjistrimit të bizneseve në Drenas)




Këto biznese ndikojnë në zhvillimin ekonomik, sigurojnë vende të reja pune dhe kontribuojnë në rritje dhe prosperitet ekonomik, nën kushtet e një kornize të favorshme ligjore dhe institucionale që mundëson treg të lirë dhe konkurrencë të barabartë.

Nga numri i bizneseve aktive me seli në Komunën e Drenasit, 30.60% përbëhen nga bizneset e sektorit G – Tregtia me Shumicë dhe Pakicë, 17.81% nga sektori F –

Ndërtimtaria, 12.58% nga sektori C – Industria Përpunuese (Prodhimtaria), 6.52% nga sektori S – Aktivitetet Tjera Shërbyese, dhe 6.18% nga sektori I – Hoteleria dhe Akomodimi.

Tabela 3. Numri i bizneseve sipas veprimtarisë

| BIZNESET AKTIVE SIPAS SEKTOREVE | NUMRI | PËRQINDJA |
|---|---|---|
| SEKTORI A – BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIM | 124 | 5,35 |
| SEKTORI B – MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE) | 5 | 0,22 |
| SEKTORI C - INDUSTRIA PËRPUNUESE | 290 | 12,53 |
| SEKTORI D – FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR | 5 | 0,22 |
| SEKTORI E – FURNIZIMI ME UJË, KANALIZIM, VEPRIMTARI E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE | 10 | 0,44 |
| SEKTORI F - NDËRTIMTARIA | 413 | 17,84 |
| SEKTORI G – TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOQIKLETAVE | 708 | 30,59 |
| SEKTORI H – TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI | 91 | 3,94 |
| SEKTORI I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR | 144 | 6,22 |
| SEKTORI J – INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI | 55 | 2,38 |
| SEKTORI K - VEPRIMTARITË FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT | 2 | 0,09 |
| SEKTORI L – VEPRIMTARITË E PATUNDSHMËRISË | 5 | 0,22 |
| SEKTORI M – VEPRIMTARITË PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE | 106 | 4,58 |
| SEKTORI N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE | 92 | 3,98 |
| SEKTORI O – ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA | 2 | 0,08 |
| SEKTORI P – ARSIMI | 23 | 0,99 |
| SEKTORI Q – VEPRIMTARITË E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE | 56 | 2,42 |
| SEKTORI R – ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI | 32 | 1,38 |
| SEKTORI S – VEPRIMTARITË E TJERA SHËRBYESE | 151 | 6,53 |
| TOTALI | 2314 | 100 |

Tregtia mbetet sektori më i madh me 30.60%, ndërtimtaria me 17,81% dhe industria përpunuese (prodhimtaria) me 12,58%.

### 6.4.3. Tregtia

Tregtia është njëri ndër sektorët më të zhvilluar dhe të rëndësishëm në komunën e Drenasit, gjithsej 708 biznese operojnë në sektorin e tregtisë.

Figura 4. Bizneset tregtare




Sektori i tregtisë me pakicë në Komunën e Drenasit, me 593 biznese, është më i zhvilluar se sektori i tregtisë me shumicë, që ka 115 biznese. Siç shihet në grafikun e paraqitur më lart, numri i bizneseve që merren me tregti me pakicë është dukshëm më i lartë. Ky sektor arrin të punësojë rreth 16.48% të të punësuarve, respektivisht 12% më shumë se sektori i tregtisë me shumicë.

### 6.4.4. Prodhimtaria dhe Përpunimi

Sektori i prodhimtarisë në Komunën e Drenasit përbëhet nga gjithsej 240 biznese prodhuese aktive dhe 18 biznese përpunuese, prej të cilave 13.10% janë biznese që merren me prodhimin e bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta, ndërsa 9.3% me prodhimin e artikujve të plastikës për ndërtimtari. Sa i përket punësimit, sektori i prodhimit të bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta, së bashku me sektorin e prodhimit të artikujve të plastikës për ndërtimtari, përbën rreth 15.62% të punësimit në këtë sektor.

Figura 5. Bizneset prodhuese dhe përpunuese




Edhe pse komuna e Drenasit ka një numër të lartë të fermerëve të regjistruar dhe aktivë, numri i bizneseve aktive në sektorin A – bujqësi, pylltari dhe peshkatari është aktualisht 124.

#### 6.4.5. Sfidat e sektorit privat në Drenas

Sektori privat në Drenas përballet me disa sfida që ndikojnë në zhvillimin dhe konkurrueshmërinë e bizneseve lokale. Këto sfida mund të kategorizohen në disa aspekte kryesore:

Shumë biznese private përballen me vështirësi për të siguruar financime ose kredi me kushte të favorshme, gjë që ndikon në zgjerimin e investimeve dhe zhvillimin e bizneseve të reja. Edhe nëse bizneset arrijnë të sigurojnë kredi, normat e larta të interesit e bëjnë të vështirë mbijetesën dhe zhvillimin e tyre në një ambient konkurrues.

Shumë të rinj të arsimuar largohen nga Drenasi në kërkim të mundësive më të mira në qytete më të mëdha në vend ose jashtë vendit, gjë që shkakton një boshllëk të madh në fuqinë punëtore dhe inovacion.

Bizneset vendase përballen me konkurrencë të ashpër nga produktet e importuara që janë më të lira, gjë që ndikon në shitjen dhe qëndrueshmërinë e bizneseve lokale.

Bizneset e vogla dhe të mesme në Drenas kanë vështirësi për të hyrë në tregjet ndërkombëtare për shkak të mungesës së burimeve dhe njohurive mbi tregjet e huaja.

Kanë vështirësi në certifikimin e produkteve dhe kompanive të tyre sipas standardeve të cilësisë, si: ISO 9001:2015; ISO 14001; ISO 22000/HACCP; ISO 27001, CE mark.

Është e nevojshme mbështetja për inovacion dhe përmirësim të vazhdueshëm, sidomos në sektorët që kërkojnë përparime teknologjike.

Përballja me kërkesat për pajtueshmëri me standardet ekologjike dhe mbrojtjen e mjedisit është sfidë për shumë biznese, duke ndikuar në kapacitetin e tyre për të eksportuar apo për të rritur qëndrueshmërinë.

Këto sfida përbëjnë një pengesë për zhvillimin e plotë të sektorit privat në Drenas, por me strategji të mirë planifikuara dhe mbështetje institucionale, ka potencial të madh për rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm.

#### 6.4.6. Gjendja e punësimit

Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) të vitit 2022, shkalla e papunësisë në nivel vendi është 12.6%. Në bazë të të njëjtit burim, shkalla e punësimit ishte 2.7% më e lartë se në vitin paraprak. Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 3.5% më e lartë se në vitin paraprak, ndërsa përqindja e femrave të punësuara ishte 1.9% më e lartë.

Ashtu si për shkallën e papunësisë, Anketa e Fuqisë Punëtore (2017) nuk ofron të dhëna mbi nivelin e punësimit në nivel komunal. Sigurimi i shifrave të përafërta të punësimit për Komunën e Drenasit, si dhe për komunat e tjera në vend, mbetet i vështirë.

Në Zyrën e Punësimit në Drenas, sipas Raportit Statistikor të Sistemit Informativ për Menaxhimin e Punësimit (SIMP) – APRK, në periudhën kohore prej 01.01.2023–31.12.2023 janë regjistruar 204 punëkërkues, prej tyre janë: 148 femra dhe 56 meshkuj, me parametrat: Statusi i papunësuar, totali 199, prej tyre 146 femra dhe 53 meshkuj.

Ndërsa gjatë periudhës kohore 01.01.2024–30.06.2024 në Zyrën e Punësimit në Drenas janë 63 punëkërkues të regjistruar në SIMP, prej tyre janë: 50 femra dhe 13 meshkuj.

Statusi i papunësuar, totali: 58, prej tyre janë: 47 femra dhe 11 meshkuj.

Është evidente që jo të gjithë të papunët lajmërohen në zyrat e punësimit si të papunë. Në mungesë të të dhënave për Komunën e Drenasit sa i përket numrit të regjistruar të punëkërkuesve dhe për të përcaktuar proporcionalisht përfaqësimin e personave nga komuna e Drenasit brenda regjionit të Prishtinës, mund të përdorim disa të dhëna demografike dhe të punësimit të komunave brenda regjionit të Prishtinës për të bërë krahasime.

Tabela 4. Punëkërkues të regjistruar sipas regjioneve

| | 2014 | 2020 | 2021 | 2022 |
|---|---|---|---|---|
| Gjakovë | 14,956 | 17,178 | 7,028 | 6,372 |
| Gjilan | 31,259 | 15,429 | 6,300 | 6,807 |
| Mitrovicë | 56,026 | 29,948 | 19,497 | 18,348 |
| Pejë | 19,598 | 16,227 | 10,053 | 10,325 |
| Prizren | 49,794 | 30,377 | 10,180 | 10,059 |
| Prishtinë | 70,452 | 44,075 | 20,945 | 21,588 |
| Ferizaj | 32,402 | 15,746 | 8,039 | 7,276 |
| Gjithsej | 274,487 | 168,980 | 82,042 | 80,775 |

Burimi: ASK, 2023

Gjatë vitit 2023, në Zyrën e Punësimit në Drenas nuk ka pasur persona me aftësi të kufizuara që janë paraqitur në Zyrën e Punësimit.

Personat me aftësi të kufizuara, kur të regjistrohen si punëkërkues për të marrë shërbime nga Zyra e Punësimit, duhet të deklarohen për paaftësinë e tyre dhe ta dëshmojnë me një dokument mjekësor për (aftësinë e tij/saj të kufizuar), dhe ne i regjistrojmë në sistem tonë në ZP.

### 6.5. Arsimi

Në Komunën e Drenasit funksionojnë 33 institucione edukative arsimore të organizuara në tri nivele të arsimit parauniversitar.

**Arsimi parashkollor** një institucion publik parashkollor amë me lokacion në Drenas dhe 2 paralele fizike në Komoran dhe Çikatovë e Re, me vijueshmëri të rregullt tërë ditore. Ndërsa klasat përgatitore – parashkollore janë të përfshira në të gjitha institucionet arsimore publike parauniversitare në Komunën e Drenasit. Në gjithë komunën, në vitin e fundit kanë qenë të përfshirë gjithsej 687 fëmijë të moshës 5 deri 6 vjeçare.

**Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët**, janë 30 institucione në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, me gjithsej 7878 nxënës.

Në Komunën e Drenasit, në arsimin fillor ka gjithëpërfshirje të fëmijëve që kanë moshën kalendarike për shkollim sipas ligjit të arsimit parauniversitar. Në vitin e fundit janë regjistruar në klasën e parë gjithsej 800 nxënës.

**Arsimi i mesëm i lartë**, në dy shkollat e mesme të larta janë të përfshirë gjithsej 2248 nxënës.

Numri i përgjithshëm i nxënësve në të gjitha nivelet është 10,641.

Numri i përgjithshëm i stafit të angazhuar në institucionet edukative arsimore është 950, prej të cilëve 746 janë mësimdhënës, ndërsa pjesa tjetër janë staf administrativ dhe mbështetës teknik.

Sikurse edhe në rajonet e tjera të vendit, edhe në Komunën e Drenasit ka rënie të ndjeshme të numrit të nxënësve si pasojë e migrimit dhe problemeve të tjera demografike.

Nga viti shkollor 2019/2020 deri në vitin shkollor 2023/2024 ka pasur një rënie të numrit të nxënësve për 11%, kurse rënia mesatare vjetore e numrit të nxënësve në Komunën e Drenasit është 2.80%.

Sa i përket raportit gjinor në vijimin e mësimit në arsimin parauniversitar, nga viti shkollor 2020-2024 numri i nxënësve meshkuj në shkollën profesionale është mbi 39% më i vogël se numri i nxënësve të gjinisë femërore.

Raporti mësimdhënës-nxënës vazhdon të qëndrojë në kuotat mesatare në krahasim me mesataren në Republikën e Kosovës: 1/16.3 në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, 1/14.3 në nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm të ulët dhe 1/8.2 në nivelin e arsimit parashkollor.

Përgatitja akademike e stafit arsimor në shkollat e Drenasit tregon se nga 750 mësimdhënës, 66.40% kanë ngritje profesionale të nivelit Bachelor, 29.37% janë të nivelit Master, dhe 4.23% janë me shkollë të lartë.

Prej 33 institucioneve edukative arsimore publike në Komunën e Drenasit, 26 punojnë në dy ndërrime, 6 punojnë vetëm në një ndërrim dhe 1 institucion parashkollor ofron qëndrim tërë ditor.

Sa i përket numrit mesatar të nxënësve në klasë, ai ndryshon nga shkolla në shkollë, por mesatarja në nivel komunal është 14.18 nxënës për klasë.

Në nivelin arsimor 1 dhe 2, largësia e udhëtimit të nxënësve shtëpi-shkollë është deri në dy kilometra.

Infrastruktura fizike e shkollave është vlerësuar në gjendje të mirë bazike dhe e krahasueshme me shtetet e rajonit për rolin e saj në mësimdhënie dhe mësimnxënie bashkëkohore.

### 6.5.1. Menaxhimi i arsimit dhe administratës në arsim

Shkollat i kanë të formuara këshillat drejtuese të shkollave, aktivet profesionale, këshillat e prindërve, këshillat e nxënësve dhe grupet e nxënësve për aktivitetet jashtëkurrikulare, ekipin për parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe ekipet e vetëvlerësimit të brendshëm.

Është shumë e rëndësishme të rritet efektshmëria e këtyre këshillave nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të tyre për rolin dhe funksionet që kanë. Sa i përket menaxherëve të shkollave, siç kërkohet nga korniza ligjore në fuqi, ata kanë përfunduar aftësimin profesional dhe trajnimet për pozitat udhëheqëse që ushtrojnë.

Përveç bashkëpunimit me institucionet vendore, DK ka bashkëpunuar në vazhdimësi me organizata të ndryshme, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare, për të garantuar aftësimin e menaxherëve të shkollave, mësimdhënësve dhe edukatorëve sipas nevojave. Sektori i arsimit në Komunën e Drenasit është përkrahur nga programi Fulbright Association – Community Colleges Chapter, Caritasi, Zyra e BE, etj

Janë krijuar kapacitete profesionale për monitorimin e implementimit të planeve të veprimit në shkolla; megjithatë, ende nevojitet mbështetje dhe fuqizim i tyre.

### 6.5.2. Sigurimi i Cilësisë

Drejtoria Komunale për Arsim, në nëntor të vitit 2023, ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit Parashkollor të Komunës së Drenasit për periudhën 2024/2025-2028/2029, ku synohet arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i avancuar, në përputhje me kohën dhe arritjet e teknologjisë, me qëllim që arsimi t'i përgjigjet zhvillimeve dinamike në vend dhe në botë.

Pasi jemi në kohën e ndryshimeve të mëdha, komuna e Drenasit – DKA do të fuqizojë administrimin, menaxhimin dhe udhëheqjen e procesit të zbatimit të zhvillimit të përshpejtuar të arsimit parauniversitar.

Deri më tani, komuna e Drenasit dallohet për administrim, menaxhim dhe udhëheqje të suksesshme dhe është model i ndryshimeve të avancuara në fushën e edukimit, arsimimit dhe aftësimit të gjeneratave të reja.

Transformimet e përshpejtuara në arsimin parauniversitar do të bëjnë që në vitin shkollor 2024/2025 të gjitha institucionet të transformohen në institucione edukative arsimore dhe aftësuese të shekullit 21, duke aplikuar inovacione dhe risi në planifikim, mbikëqyrje, monitorim, administrim, menaxhim dhe udhëheqje; si dhe në punën e organeve profesionale (këshillat e arsimtarëve, aktivet profesionale, këshillat e nxënësve, grupet edukative, klasat, paralelet dhe kujdestarët e klasave) dhe në shërbimet profesionale (pedagogjike, psikologjike, zyrat e cilësisë, bibliotekat dhe mediatikat, logopedia dhe shërbimet shëndetësore).

Në mënyrë që të bëhet ndërlidhja e aftësive me tregun e punës, DKA, në bashkëpunim me DHZE dhe shkollën profesionale, kryejnë analiza të nevojave të tregut të punës në mënyrë periodike. Në bazë të të gjeturave dhe konkluzioneve, rishikojnë drejtimet ekzistuese dhe krijojnë drejtime të reja të mësimit DUAL (mundësi për punësim dhe vetëpunësim të të rinjve) që përputhen me nevojat e tregut të punës.

Shkolla profesionale ka bashkëpunime dhe marrëveshje të lidhura me biznese vendore dhe ndërkombëtare për aftësimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve, sipas kërkesave të tregut të punës.

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare nënkupton gjithashtu që shkollave t'u ofrohen investime kapitale, mallra dhe shërbime.

- Në bazë të të dhënave të paraqitura më poshtë, vërehet se komuna është angazhuar mjaft (brenda mundësive financiare) për pajisjen e shkollave me infrastrukturën e nevojshme teknologjike, laboratorike, bibliotekat dhe sallat e edukatës fizike:
- Me kabinete të TIK janë të pajisura 32 institucione arsimore publike parauniversitare.
- Me laboratorë të shkencave janë të pajisura 32 institucione arsimore publike parauniversitare
- Me bibliotekë janë të pajisura 32 institucione arsimore publike parauniversitare.
- Me palestra sportive janë të pajisura 8 institucione arsimore publike parauniversitare.
- Me fusha sportive janë të pajisura 32 institucione arsimore publike parauniversitare.

### 6.6. Infrastruktura

#### 6.6.1. Infrastruktura publike

Komuna e Drenasit është e pozicionuar në qendër të Republikës së Kosovës. Ky pozicion i mundëson të gjitha vendbanimeve në komunë të kenë lidhje të afërta rrugore me qytetin, si dhe i jep përparësi komunës së Drenasit përmes lidhjeve të mira me të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

Sipas Sistemit ARIS të regjistrit të rrugëve në nivel komunal, gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor është 570.20 km, prej të cilave 512.5 km janë rrugë lokale, 35.4 km janë rrugë rajonale, 19.53 km janë rrugë nacionale, dhe 2.78 km janë autoudhë. (Shënim: Gjatësia e rrugëve me 4 korsi është llogaritur vetëm në një anë të rrugës).

Infrastruktura rrugore në komunë është kryesisht me dy korsi, përveç rrugës nacionale Prishtinë-Pejë, me gjatësi prej 19.53 km, dhe segmentit të shkurtër të autoudhës "Rruga e Kombit" me gjatësi 2.78 km, të cilat janë me 4 korsi. Rruga nacionale Prishtinë-Pejë, segmenti i autoudhës dhe rrugët tjera nacionale dhe rajonale shërbejnë si nyje kyçe për transportin rrugor, dhe gjendja e tyre konsiderohet kryesisht e mirë.

Rrjeti rrugor lokal ka një gjatësi prej 512.5 km, prej të cilave rrugë me zhavorr janë 40.42 km (7.89%) dhe të asfaltuara janë 472.058 km (92.10%). Rrjeti rrugor lokal i Komunës së Drenasit lidhet me rrjetin e rrugëve nacionale përmes rrugëve Prishtinë-Pejë dhe Mitrovicë-Lipjan. Kryqëzimet kryesore në komunë janë në Komoran dhe në hyrje të Drenasit, tek rrethi.

Rrugët lokale ofrojnë lidhje të mirë ndërmjet vendbanimeve në zona rurale dhe me qytetin e Drenasit. Rrugët lokale janë kryesisht në gjendje të mirë. Me fokus të veçantë duhet të trajtohen segmentet e rrugëve që kalohen nga fëmijët në baza ditore (shtëpi-shkollë-shtëpi) dhe segmentet ndërmjet fshatrave.

Ndotjet akustike dhe pluhuri janë dukuri të zakonshme që vijnë si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda.

Prej gjithsej 472.058 km rrugë të asfaltuara, 73.554 km janë të pajisura me trotuare, që përfaqëson 15.58% të totalit. Është me rëndësi që në rrugët me qarkullim të theksuar të banorëve, veçanërisht të nxënësve, të ndërtohen trotuare.

#### 6.6.2. Infrastruktura hekurudhore

Komuna e Drenasit ka rrjetin hekurudhor me pesë terminale hekurudhore në Dobroshec, Drenas, Damanek, Baicë dhe Tërdec. Në shërbim të udhëtarëve janë 3 operime ditore në linjën Fushë Kosovë - Drenas - Pejë. Infrastruktura hekurudhore është nën menaxhim të kompanisë publike "INFRAKOS".

**Transporti ndërurban** i udhëtarëve ka për shërbim një stacion të autobusëve me 12 vend-parkingje për autobusë dhe 24 vend-parkingje për taksi. Linjat e autobusëve

lidhin Drenasin me Shqipërinë, qytetet Prishtinë, Malishevë dhe Skenderaj, si dhe me të gjitha vendbanimet e Drenasit në të dy drejtimet. Frekuentimi bëhet kryesisht me autobus (shih shtojcën), por në disa fshatra përdoren edhe minibusë.

### 6.6.3. Menaxhimi i Mbeturinave në Komunën e Drenasit

Komuna e Drenasit ka hartuar Planin Komunal dhe Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave, së bashku me objektivat dhe aktivitetet e parapara për 5 vite.

Nga analizimi i të dhënave të raporteve nga komuna dhe operatori për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale, KRM "Pastrimi" Sh. A., njësia operative në Drenas, janë nxjerrë të dhënat për sasinë e grumbulluar të mbeturinave komunale gjatë vitit 2023.

Sipas raportit të KRM "Pastrimi," sasia totale e mbeturinave të grumbulluara nga 7447 ekonomi familjare të shërbyera, që mbulojnë 58,531 banorë, rezulton se gjenerimi i mbeturinave komunale për banor në Komunën e Drenasit për vitin 2023 është përafërsisht 127 kg/banor/vit.

Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave për tërë territorin e komunës ofrohet nga KRM "Pastrimi" SH.A., njësia operative në Drenas

**Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare deri në** fund të vitit 2023 në komunën e Drenasit ka arritur në 84.76%.

### 6.6.4. Ujësjellësi

Ndërtimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit është realizuar përmes investimeve nga donatorë të ndryshëm, komuna, si dhe me kontribut të qytetarëve. Sistemi i ujësjellësit në Komunën e Drenasit menaxhohet nga njësia operative e kompanisë rajonale për ujë dhe kanalizim KRU "Prishtina." Vendbanimet me ujësjellës janë gjithsej 12, ndërsa 3 vendbanime kanë pjesërisht ujësjellës, dhe 20 vendbanime janë pa ujësjellës.

Nga numri i banorëve në këto vendbanime rezulton se rrjeti i ujësjellësit mbulon dhe shërben 26,116 banorë (44.6%), pjesërisht kanë qasje 6481 banorë (11.1%), ndërsa plotësisht pa ujësjellës janë 25,934 banorë (44.3%). Furnizimi me ujë bëhet nga fabrika për përpunimin e ujit në fshatin Çikëtova e Vjetër, e cila është ndërtuar për furnizimin me ujë industrial dhe për pije të kompleksit industrial të Feronikelit. Për shkak të mungesës së ujit të pijshëm në këtë rajon, nga kjo fabrikë furnizohet qyteti i Drenasit dhe disa fshatra përreth. Fabrika përdor ujin nga liqeni artificial i Ujmanit në pjesën veriore të Republikës së Kosovës.

Komuna, së bashku me donatorë, ka investuar edhe në rregullimin e stacionit të pompimit në fshatin Çikëtovë e Vjetër, si dhe në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimin e dy rezervuarëve në Gollbar tek Pishat.

Edhe pse sistemi i ujësjellësit mbulon më pak se gjysmën e territorit të komunës, në zonat ku ka ujësjellës, humbjet e ujit në sistemin distributiv janë të larta dhe

vlerësohen të jenë midis 57% dhe 60%. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së ujit të prodhuar dhe sasisë së faturuar. Faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë shkallë të lartë humbjesh përfshijnë rrjetin e vjetëruar të ujësjellësit, kyçjet ilegale dhe matjet e pasakta të ujit.

Pjesa e popullatës që nuk ka qasje në sistemin qendror të furnizimit me ujë pritet të furnizohet deri në fund të vitit 2024 ose fillim të vitit 2025, varësisht nga progresi i punimeve në terren.

### 6.6.5. Kanalizimi fekal

Sistemi i kanalizimit është i tipit të ndarë, në Komunën e Drenasit, rol dominues në shpërndarjen dhe shtrirjen e rrjetit të kanalizimit, ka luajtur konfiguracioni i terrenit. Rrjeti është i shpërndarë nëpër pika të caktuara të lagjeve dhe fshatrave. Të gjitha fshatrat e Komunës së Drenasit e kanë të instaluar Rrejtin primar të kanalizimit.

"Për vendbanimet me rrjet kanalizimi, të gjithë ujërat e kanalizimit, pa trajtim paraprak, shkarkohen fillimisht në kolektorët kryesorë që janë të ndërtuar nga fshati Polluzhë në drejtim të Drenasit, përgjatë shtratit të lumit Verbica, si dhe nga fshati Nekoc në drejtim të Drenasit, përgjatë lumit Drenica. Për momentin, këto ujëra derdhen në rrjedhat e lumit Drenica, dhe në këtë mënyrë shkaktojnë ndotje të lumit, tokës dhe, sigurisht, edhe ujërave nëntokësorë. Kolektorët kryesorë që përcjellin ujërat e kanalizimit fekal janë HDPE me diametra prej Ø 400 mm – 1000 mm."

I gjithë rrjeti i kanalizimit fekal në pjesën urbane menaxhohet nga Kompania KRU "PRISHTINA", ndërsa në fshatra është i menaxhuar nga kompania e kontraktuar nga komuna. Për hapësirat rurale nuk ka informacione lidhur me rrjetat e kanalizimit, sepse ato nuk menaxhohen nga 'Ujësjellësi - Njësia Operative e Ujësjellësit' në Drenas.

**Rrjeti i kanalizimit atmosferik** është ndërtuar pas atij fekal për arsye se ka qenë i organizuar në drejtim të rrjetit hidrografik që gjendet në Komunën e Drenasit. Rrjeti i kanalizimit atmosferik është krejtësisht i orientuar në drejtim të lumit Drenica dhe përroskave të tjera, siç është ajo e Verbovcit. Gypat janë nga materiale të ndryshme, si beton, PVC etj., me dimensione të ndryshme.

Pasi që ndërtimi ka marrë hov vitin e fundit (2022-2023), atëherë duhet të parashihet edhe rirregullimi i rrjetit, ku duhet të vendosen gypa me diametër më të madh, si për kanalizimin fekal ashtu edhe për kanalizimin atmosferik. Kjo është e nevojshme sepse rrjeti ekzistues në disa pjesë të qendrës së qytetit nuk i plotëson kërkesat për kanalizim për shkak të rrjetit të vjetruar dhe seksionit të gypave jo adekuat për numrin e ekonomive familjare.

### 6.6.6. Energjetika

Komuna e Drenasit furnizohet me energji elektrike nga Nënstaconi i Drenasit (NS 110/(10-20) Kv, me dy transformator 2x40 MVA që është në pronësi të KEDS-it, përmesë largëpëruesit i 220 kV.

Në tër territorin e komunës janë ka gjithsej rreth 15.445 konsumator, prej tyre banim (amvisëri-shtëpiak) janë 13.139 konsumator, dhe komercial (biznese) janë 2.036 konsumator.

### 6.6.7. Telekomunikacioni

Në territorin e Komunës së Drenasit veprojnë tre operatorë: Vala, Telekomunikacioni i Kosovës (TK) dhe IPKO të cilët ofrojnë telefoni fikse, mobile, televizion kabllor dhe internet brenda zonës urbane, si dhe në të gjitha vendbanimet rurale. Në rastet e shumta, linjat telekomunikuese përdorin rrjetin ajror të KEDS-it, respektivisht shtyllat e tensionit të ulët, pa ndonjë planifikim paraprak. Megjithatë, gjendja aktuale e infrastrukturës së telekomunikacionit në komunën e Drenasit është relativisht e mirë.

### 6.6.8. Hapësirat publike ( Parqet dhe Sheshet)

Komuna e Drenasit ka të identifikuara 8 hapësira publike që gjenden në qytetin e Drenasit: Sheshi "Fehmi Lladrovci"; Parku i qytetit (ku sheshi dhe parku janë duke u rirregulluar dhe pritet që punimet të përfundojnë në vitin 2025); Parku i Komunës së Re; Parku i Komunës së Vjetër; Hapësira e gjelbëruar e Banesave (tek 5 blloqet); Hapësira e gjelbëruar tek Çerdhja "Ardhmëria"; Hapësira e gjelbëruar e Qendrës së Re Zejtare; dhe në vitin 2023 është duke u rregulluar edhe parku tek Pishat në Gllobar, ku po bëhen investime në rregullimin e shëtitoreve në këtë park dhe investime të tjera që priten (ndriçim publik, ulëse, shporta për mbeturina etj.). Në total, janë 65.71 ha sipërfaqe të hapësirave të gjelbërta, të cilat mirëmbahen rregullisht..

Në komunën e Drenasit përfshihen hapësira të projektuara për të akomoduar automjetet – parkingjet.

**Parkingjet ekzistuese të menaxhuara nga Komuna** janë: Hapësirat publike (sheshet dhe parqet), kapacitetet infrastrukturore - vendparkimet.

### 6.7. Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

Komuna e Drenasit ka rritur angazhimin dhe projektet për përmirësimin e sektorit shëndetësor dhe të mirëqenies në Drenas. Përmirësimet janë bërë kryesisht në ndërtimin dhe renovimin e institucioneve të reja të mjekësisë familjare, furnizimin me pajisje të reja dhe moderne mjekësore, si dhe furnizimin e rregullt me inventarë. Ngjashëm, është angazhuar edhe në fushën e Mirëqenies Sociale, veçmas në zgjidhjen e çështjes së banimit të përkohshëm, varësisht nga kërkesat për strehim.

Shërbimet e kujdesit primar shëndetësorë për qytetarët e komunës së Drenasit ofrohen përmes:

- Një (1) Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare;
- Dy (2) Qendra të Mjekësisë Familjare; dhe
- Nëntë (9) Ambulanta të Mjekësisë Familjare në pjesët rurale.

Në QKMF janë të punësuar gjithsej 190 punonjës, prej të cilëve 52 janë mjekë/mjekë specialistë, nga të cilët konsulentë specialistë janë gjithsej 12, infermierë 127, 5 vozitës të autoambulancës dhe 6 staf administrativ.

Tabela 5. Numri i personelit në QKMF

| | F | M | Totali |
|---|---|---|---|
| **Nr. i mjekëve** | 29 | 23 | 52 |
| **Infermier** | 107 | 20 | 127 |
| **Administratë** | 2 | 4 | 6 |
| **Vozitës** | 0 | 5 | 5 |
| **Gjithsej** | **136** | **54** | **190** |

Sa i përket gjendjes ekzistuese të objekteve shëndetësore në komunën e Drenasit, nga gjithsej 12 objekte shëndetësore, 8 objekte janë vlerësuar të kenë gjendje të mirë, 1 shkëlqyeshëm, dhe 3 objekte me gjendje jo të mirë për arsye se mungon hapësira e mjaftueshme, si dhe plotësimi me inventar të kompletuar sipas udhëzimit administrativ.

Tabela 6. Institucionet shëndetësore, vendi, gjendja e objektit dhe inventari

| Institucioni | Vendndodhja | Gjendja e objektit | Hapësira | Inventarizimi |
|---|---|---|---|---|
| QKMF | Drenas | Mirë | Mjaftueshëm | Funksionale |
| QMF | Komoran | Mirë | Mjaftueshëm | Funksionale |
| QMF | Terstenik | Mirë | Mjaftueshëm | Funksionale |
| AMF | Baicë | Shkëlqyeshëm | Mjaftueshëm | Pjesërisht |
| AMF | Abri e Ep | Mirë | Mjaftueshëm | Pjesërisht |
| AMF | Gllanasellë | Mirë | Mjaftueshëm | Funksionale |
| AMF | Gradicë | Jo e mire | Jo mjaftueshme | Pjesërisht |
| AMF | Dobroshec | Jo e mirë në renovim | Jo mjaftueshme | Pjesërisht |
| AMF | Vasilevë | Jo e mirë | Jo e mjaftueshme | Pjesërisht |
| AMF | Arllat | E mirë | Jo e mjaftueshme | Funksionale |
| AMF | Sankoc | E mirë | Mjaftueshëm | Pjesërisht |
| AMF | Nekoc | E mirë | Mjaftueshëm | Pjesërisht |

Nga gjithsej 12 objekte shëndetësore në komunën e Drenasit, 8 prej tyre posedojnë hapësirë të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ndërsa 4 objekte kanë nevojë për zgjerimin e hapësirës punuese.

Pavarësisht shtrirjes së madhe të rrjetit të institucioneve shëndetësore, numri i vizitave në QKMF vazhdon të mbetet i lartë. Në vitin 2023, numri i vizitave ishte 190,578, numri i shërbimeve 353,233, dhe totali i vizitave dhe shërbimeve ishte 543,811. Në gjashtëmujorin e vitit 2024, kanë qenë 85,983 vizita, 191,625 shërbime, dhe gjithsej numri i vizitave dhe shërbimeve ishte 277,608.

Qendra për Punë Sociale

Në komunën e Drenasit, shërbimet sociale ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale si dhe asistenca sociale. QPS funksionon me gjithsej 11 zyrtarë të punësuar, nga të cilët 4 janë të angazhuar në ofrimin e shërbimeve sociale, 5 në asistencën sociale, 1 zyrtar financiar si dhe drejtori i QPS.

**Qendra për Punë Sociale Funksionon me dy sektorë:**

1. ***Sektori i Shërbimeve Sociale***
2. ***Sektori i Mirëqenies Sociale***

**Sektori i shërbimeve sociale**

Veprimtaria e Shërbimeve Sociale të Qendrës për Punë Sociale fokusohet kryesisht në mbrojtjen e këtyre kategorive por jo vetëm:

- Mbrojtja sociale të fëmijëve dhe rinisë,
- Përkujdesja dhe mbrojtja e fëmijëve pa kujdes prindor,
- Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta dhe atyre me sjellje të çrregulluara,
- Mbrojtja sociale e të rriturve në gjendje të nevojës sociale,
- Mbrojtja e të rriturve me nevoja të veçanta,
- Mbrojlja e të moshuarve pa kujdes familjar dhe pa mjete për jetesë,
- Punët e kujdestarisë, dhe
- Mbrojtja e familjes në realizimin e të drejtave juridike.

### 6.8. Gjendja e bujqësisë në Komunën e Drenasit

Bujqësia konsiderohet si një nga sektorët më të rëndësishëm në tërë ekonominë e komunës së Drenasit. Gjithashtu, është një nga sektorët që ka ndikim të madh dhe të rëndësishëm në ofrimin e mundësive për punësim dhe në krijimin e të ardhurave për ekonomitë familjare

Megjithatë, ky sektor nuk ka pasur përkrahjen e nevojshme deri në këto vitet e fundit, meqenëse shumica e projekteve të mëdha nuk janë përfshirë në hartën e aktiviteteve të tyre, pasi ato janë orientuar kryesisht në regjionet më "të njohura bujqësore." Në vitet e fundit, duke iu falënderuar rritjes së përkrahjes nga institucionet qendrore dhe lokale, si dhe investimeve nga ana e fermerëve, ky sektor po ngrihet gradualisht.

Komuna e Drenasit ka një sipërfaqe prej 27,563.00 ha, prej të cilave 14,389.00 ha janë tokë bujqësore; nga kjo sipërfaqe, 5,600 ha janë nën sistemin e ujitjes, ndërsa tokë pyjore ka 11,200 ha.

Lartësia mbidetare varion nga 500-650 m. Rreth 46% e sipërfaqes së territorit të Komunës së Drenasit gjendet në lartësinë mbidetare rreth 650 m, lartësi kjo që është e përshtatshme për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore. Pika më e lartë është 1,072 m.

Pjesa e rrafshët e komunës, sidomos lugina përgjatë lumit "Drenica," është tokë me potencial për zhvillimin e bujqësisë intensive. Lumi "Drenica," kanali i sistemit ujitës Ibër-Lepenc, si dhe lumi Verboc, janë faktorë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë.

Kushtet klimatike janë të përshtatshme për kultivimin e shumicës së kulturave bujqësore.

Bujqësia në komunën e Drenasit karakterizohet nga përpjekjet për transformim nga bujqësia që prodhon për nevojat e familjes në atë gjysmë komerciale dhe komerciale.

Shumica e familjeve posedojnë sipërfaqe të tokës mjaft të vogla (1 deri në 2.5 ha) dhe, në shumicën e rasteve, ato janë të shpërndara në disa parcela. Ky faktor është kufizues për aplikimin e teknologjive bashkëkohore.

Sipërfaqet e tokës së punueshme i janë nënshtruar shkatërrimit të pakontrolluar, edhe pse në nivel më të vogël se në komunat tjera. Ndërtimi i shtëpive pa plan, si dhe objekteve të tjera përcjellëse (të cilat do të mund të ndërtoheshin në toka më pak cilësore), kanë bërë që fondi i tokës bujqësore të zvogëlohet në vazhdimësi.

Fermerët shpesh kanë vështirësi në gjetjen e tregjeve të qëndrueshme për të shitur produktet e tyre, duke u detyruar të shesin me çmime të ulëta. Kjo situatë është pasojë e mungesës së njohurive të fermerëve për mënyrën se si t'i qasen tregjeve bashkëkohore, mungesës së promovimit të produkteve bujqësore, mungesës së pikave grumbulluese, si dhe pajisjeve për klasifikimin dhe paketimin e produkteve bujqësore.

Një problem specifik për këtë komunë është mosshfrytëzimi i sistemit të ujitjes nga ana e fermerëve. Edhe pse me këtë sistem janë të mbuluar rreth 5,600 ha (afër 40% të tokës bujqësore të komunës), shfrytëzimi i tij për ujitje është vetëm rreth 500 ha. Kjo është një situatë për të cilën komuna, në bashkëpunim me fermerët lokalë, duhet të gjejë një zgjidhje. Analizat e shumta tregojnë se mungesa e ujitjes është një faktor kufizues për zhvillimin e bujqësisë në shumë regjione të vendit. Është një humbje e madhe, sidomos për komunën, por edhe për bujqësinë e vendit, që fermerët të mos kenë interesim për ta shfrytëzuar këtë sistem të ujitjes. Ky duhet të jetë një nga objektivat kyç në 4 vitet e ardhshme.

Mungesa e organizimit të fermerëve në shoqata, kooperativa, apo forma të tjera, i bën ata të mos jenë konkurrentë në tregjet lokale e as në ato rajonale e më gjerë. Kjo mund

të vërehet edhe me mungesën e mekanizimit bashkëkohor (sidomos në sektorin e pemëve dhe perimeve).

Bazuar në faktin se shumica e fermave dhe kapaciteteve përpunuese janë të vogla, duhet të inkurajohet bashkëpunimi horizontal ndërmjet ekonomive bujqësore, me qëllim ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përmirësimin e cilësisë. Ky bashkëpunim do të mundësonte rritjen e zingjirit të vlerës së produkteve, duke e rritur vlerën e tyre në treg.

Siç ndodh edhe në shumicën e rajoneve të vendit, edhe në komunën e Drenasit, marrja me bujqësi është kryesisht profesion i njerëzve më në moshë. Ky fenomen krijon vështirësi për arritjen e efekteve të dëshiruara, posaçërisht kur kemi të bëjmë me futjen e teknologjive të reja dhe inovacionit në bujqësi. Bazuar në këtë fakt, është me rëndësi që përmes formave të ndryshme të përkrahjes (subvencione, grante) të përkrahen të rinjtë dhe gratë që të orientohen drejt këtij sektori.

Komuna e Drenasit ka një buxhet shumë modest për këtë sektor, rreth 30,000 euro, ndërsa bashkëpunimet e planifikuara me donatorë arrijnë deri në 125,000 euro.

Është shumë e rëndësishme që të gjenden edhe forma të tjera të përkrahjes, duke shfrytëzuar projekte dhe donatorë të ndryshëm. Kjo ka rëndësi shumë të madhe sidomos për fermerët e vegjël, pasi ata zakonisht nuk përfshihen në skemat e subvencioneve dhe granteve.

### 6.8.1. Sektori i prodhimit bimorë

Në rajonin e komunës së Drenasit dominojnë sipërfaqet me drithëra (grurë, misër, elb, tërshëre). Në tabelën në vijim janë dhënë sipërfaqet për të cilat fermerët kanë aplikuar për subvencione. Ku shihet se dominim absolut kanë drithërat por edhe tek pemët e perimet ka një tendencë të rritjes së sipërfaqeve. Në krahasim me regjistrimin e bujqësisë të bërë në vitin 2014, pothuajse në çdo sektor ka rritje të sipërfaqeve, sidomos te pemët dhe perimet që shkon deri 100%.

**Tabela 7. Aplikuesit tre vitet e fundit (2022,2023,2024)**

| Vitet | Nr. i fermerëve | Grurë/ ha | Misër/ ha | Elb/ ha | Tërshër/ha | Thekër/ha | Pemë/ ha | Perime/ha |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | 1004 | 1913.93 | 1917.18 | 28.52 | 60.55 | / | 170.44 | 94.92 |
| 2023 | 1163 | 2643.6 | 2014.1 | 23.19 | 74.59 | 2.43 | 166.5 | 54.41 |
| 2024 | 1127 | 2500.00 | 2400.10 | 44.6 | 99.33 | 1.05 | 200.00 | 170.08 |

Burimi: Drejtoria për Bujqësi, 2024

Nga pemët dominojnë mollët me rreth 75% dhe kumbulla me rreth 15%. Në këto tre vitet e fundit kanë filluar me kultivimin e sipërfaqeve të mbjella edhe me pemë me vlerë siç janë arra, lajthia dhe pemët e imëta (fruta manore).

Sa i përket sipërfaqeve me perime edhe pse ka rritje të sipërfaqeve, ende shumica e sipërfaqeve janë për prodhim për nevojat e familjes, sasi shumë e vogël për treg.

Gjithashtu edhe teknologjia e kultivimit të tyre është ende larg nivelit të prodhimit bashkëkohor të perimeve. Rreth 70 % të sipërfaqeve me perime janë me spec, domate, tranguj dhe qepë. Perimet e tjera janë në sipërfaqe shumë të vogla, kryesisht në kopshte për rreth shtëpive për nevoja të familjes.

Sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohen kultivuesit e këtyre kulturave bujqësore në komunën e Drenasit janë: fragmentimi i tokës, mekanizimi i vjetruar, mungesa e mjeteve financiare për investime, mungesa e masave mbrojtëse nga breshëri, mungesa e pikave për grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimeve, produktiviteti i ulët si pasojë e pemishteve të vjetërsuara, përmbytjet e plantacioneve si pasojë e vërshimeve dhe mungesës së sistemeve të drenazhës në to.

Duke pasur parasysh sipërfaqet e vogla të tokës që kanë fermerët, sektori i pemëve e posaçërisht i perimeve mund të jetë me shumë interes për të ardhmen e bujqësisë së komunës së Drenasit. Kjo është sidomos me rëndësi kur kemi sipërfaqe të mëdha që mund të ujiten në këtë komunë.

Është shumë me rëndësi ngritja e kapaciteteve të fermerëve (përmes, trajnimeve, vizitave te prodhuesit e komunave tjera, dhe atyre të regjionit) në mënyrë që ata të jenë në gjendje të aplikojnë teknologjitë moderne dhe ato inovative në prodhimin bimorë.

Krijimi i pikave grumbulluese për ruajtjen e pemëve dhe perimeve është një masë tjetër e promovimit të produkteve lokale bujqësore. Organizimi i një panairi lokal të produkteve bujqësore dhe pjesëmarrja e prodhuesve në panaire tjera do të ishte me shumë interes.

### 6.8.2. Sektori i Bletarisë

Një prej sektorëve më profitabil në fushën e bujqësisë është edhe bletaria. Komuna e Drenasit ka një pozitë të volitshme gjeografike për kultivimin e bletarisë. Aktualisht, në komunën e Drenasit llogariten të jenë mbi 5000 koshere bletësh.

Ky sektor është përkrahur nga komuna në formën e rritjes së numrit të koshereve dhe bletarëve, por me gjithë përkrahjen nga komuna bletarët nuk kanë arritur të zhvillohen për sa i përket rritjes së numrit të produkteve të bletës, si psh.: propolisi, qumështi i bletës, poleni, etj. Bletarët janë të organizuar nëpërmjet Shoqatës së Bletarëve, ku herë pas here mbajnë trajnime dhe ligjërata për bletarët e rinj, mbi kultivimin e bletëve. Megjithatë, edukimi i bletarëve edhe më tutje mbetet sfidë e komunës dhe e Shoqatës së Bletarëve, sidomos në kontrollin dhe menaxhimin e sëmundjeve të bletëve. Regjistrimi i bletishteve, krijimi i pasaportës së bletës, lokalizimi i bletishteve, kultivimi i bimëve mjaltë-dhënëse dhe përpilimi dhe monitorimi i listës së sigurt të barnave për bletët, mbetet edhe më tutje sfidë për bletarët, Shoqatën e Bletarëve dhe komunën e Drenasit.

Përkushtimi i komunës duhet të fokusohet në avancimin e bletarisë në Drenas, nëpërmjet avancimit të bletarëve në aspektin profesional, zgjerimin e produkteve të bletës, dhe rritjen e kontrollit dhe menaxhimit të sëmundjeve të bletëve.

### 6.8.3. Sektori i Blegtorisë

Në komunën e Drenasit ekziston potencial i lartë për zhvillimin e blegtorisë, meqë kualiteti i tokës, kushtet klimatike, por edhe burimet e ujit janë mjaft të favorshme. Sipas të dhënave nga Regjistrimi i Bujqësisë i vitit 2014, Drenasi posedon rreth 6,692 ha me livadhe dhe kullota, të cilat paraqesin mundësi të mëdha për zhvillimin e blegtorisë. Për më tepër, si përparësi është që 86% të sipërfaqeve të kullotave janë kullota në tokë të përbashkët.

Rreth 4000 ekonomi bujqësore merren me rritjen e gjedheve, deleve si dhe dhive ndërsa prodhimi i mishit dhe bulmetit, janë produktet kryesore që prodhohen nga sektori i blegtorisë në komunën e Drenasit. Shumë pak prej ekonomive bujqësore në komunën e Drenasit merren me rritjen dhe mbajtjen e gjedheve për nevojat e konsumit familjar kurse pjesa më e madhe prej tyre i mbajnë për nevoja të tregut.

Në sektorin e shpezëtarisë-madhësia e tufës së shpendëve deri në 150 copë, përfaqësohet rreth 70% e ekonomive bujqësore.

Tabela 8. Aplikuesit tre vitet e fundit (2022,2023,2024)

| Vitet | Lop | Dele | Dhi | Bletë | Pula | Bimë mjekësore |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2022 | 1450 | 3922 | 632 | 4369 | 10000 | 3.33 |
| 2023 | 1441 | 4865 | 518 | 3951 | 27000 | 1.36 |
| 2024 | 1900 | 5017 | 631 | 5458 | 8000 | 2.5 |

Fermerët e gjedheve në komunën e Drenasit kanë nevojë për investime në stalla dhe objekte përcjellëse. Investim në makineri të reja për prodhimin e ushqimit për kafshë duke i modernizuar ato në përputhje me standardet ekzistuese për mirëqenie të kafshëve dhe mjedisit.

Në komunën e Drenasit aktualisht nuk ka pikë grumbulluese të qumështit apo nënprodukteve të qumështit, prandaj është e rëndësishme të nxitet dhe ndihmohet krijimi i dy deri tre qendrave grumbulluese për prodhime blegtorale, ku blegtorët do të kenë mundësi që të bëjnë grumbullimin e qumështit apo nënprodukteve të qumështit.

Është shumë me rëndësi që fermerët të përgatiten edhe për arritjen e standardeve për siguri dhe higjienë të ushqimit, për mirëmbajtje të kafshëve dhe mbrojtje të mjedisit. Komuna duhet të angazhohet në rritjen e ndërgjegjësimit të fermerëve ndaj ndotjes së mjedisit, posaçërisht ndikimit që mbetjet e ndryshme nga ferma mund të ketë tek ujërat nëntokësorë.

### 6.9. Turizmi dhe trashëgimia kulturore, rinia dhe sporti

### 6.9.1. Turizmi

Edhe pse komuna e Drenasit karakterizohet me mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit kulturor dhe rural, kjo pjesë e aktivitetit ekonomik, është pothuajse krejtësisht e pashfrytëzuar. Viset malore siç janë Çyçavica, Vargmalet e Berishës e Kosmaçi e rrisin potencialin konkurrues për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në komunën e Drenasit.

Vendet me potencial të lartë turistik dhe atraktive për zhvillimin e turizmit përfshijnë: Pishat e Gllobarit ,Kalaja e Vuçakut ,Kalaja e Verbovcit, Liqeni i Vasilevës, lumenjtë Drenica dhe Verbica, Gryka e "Gurit të Plakës". Guri i Gradinës, Pishat e Komoranit, dhe vende të tjera. Këto janë disa nga burimet më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit të Drenasit.

Megjithatë, në këtë komunë nuk egziston ende një ofertë e strukturar për akomodim dhe hapësira për kamping, që kryesisht mund të ofrohen në afërsi të Liqenit të Vasilevës. Synimi është ngritja e standardeve të akomodimit për të përmbushur pritjet e vizitorëve dhe për të krijuar vlerë të shtuar në këtë sektor. Për më tepër, rritja e investimeve dhe promovimi i shpellave si Shpella e Peshterrit në Nekovc, Shpella e Kizharekës, Shpella e Kokilit në Verboc, Shpella e Baicës dhe Shpella e Gllanasellës do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e vizitave turistike, si nga turistë vendorë ashtu edhe të huaj. Po ashtu, komuna e Drenasit ka një trashëgimi mjaft të pasur kulturore, me monumente të rëndësishme që datojnë nga periudha të ndryshme historike, si Kalaja e Vuçakut dhe Kalaja e Verbocvit. Këto monumente ofrojnë një pasuri të vlefshme për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit kulturor në këtë zonë.

**Zhvillimi i Produkteve Turistike**

Në bashkëpunim me agjenci dhe operatorë turistikë vendor dhe ndërkombëtar duhet të zhvillohen dhe promovohen paketa të reja turistike. Përveç kësaj, rekomandohet të bëhet listimi i të gjitha atraksioneve turistike dhe të trashëgimisë kulturore në platformat online siç janë: Trip Advisor, Four Square, Wikipedia, etj. Gjithashtu, të bëhet shënjëzimi dhe digjitalizimi i shtigjeve të vrapimit dhe ecjes malore.

Dy atraksione turistike qe ja vlejnë te theksohen janë :

**Kalaja e Vuçakut**, ndodhet rreth 12 kilometra në jugperëndim të Drenasit, shtrihet mbi dy kreshta shkëmbore dhe ka qenë një pikë e rëndësishme gjeostrategjike që nga antikiteti. Kjo u dëshmua me muret rrethuese, mbrojtëse dhe banimit të hershëm, ku u zbulua spolia me shkrim dedikuar një perandori romak. Gërmimet arkeologjike në Kalanë e Vuçakut kanë filluar në vitin 2017 nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, nën udhëheqjen e arkeologut Shafi Gashi. Megjithatë, sado premtuese ishin gërmime, ato u ndërprenë në vitin 2019 për shkak të mungesës së buxhetit, ndërsa në kohën e pandemisë, gërmimet u ndërprenë plotësisht dhe rifilluan me sukses në vitin 2024. Në

këto gërmime të reja, është zbuluar një altar romak në murin rrethues të kalasë, i cili daton në gjysmën e parë të shekullit III të Epokës së Re. Ky altar është një spolie i ripërdorur në ndërtimin e kalasë gjatë periudhës së Justinianit (527-565). Zbulimet arkeologjike tregojnë për vazhdueshmërinë e jetës në këtë vend nga parahistoria, në mesjetë e deri më sot, duke zhvendosur kufijtë dhe hartat e pranisë së monumenteve kushtuar perandorëve romakë si dhe artefakteve të hershme duke përfshirë enë tryeze dhe amfora transporti. Ky zbulim tregon se Kalaja e Vuçakut ka qenë një vend i rëndësishëm për jetën shoqërore në zemrën e Kosovës, duke qenë në lidhje me Kalanë e Vërbocit dhe Gradinës së Llapushnikut, të cilat do të hulumtohen dhe harta arkeologjike do të pasurohet për komunën tonë dhe Kosovën si destinacion turistik-arkeologjik me vlera të mëdha.

**Pishat e Gllobarit** Gllobari është fshat i cili gjendet shumë afër qytetit të Drenasit. Në këtë fshat gjindet parku i cili është mjaft i njohur për pyjet e bukura me pisha të cilat ofrojnë një pamje të mrekullueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të turizmit. Ky vend i cili në të kaluarën ishte mjaft i popullarizuar për vendasit lokal tashmë me investimet e reja nga ana e komunës së Drenasit ka filluar të bëhet atraksion i ri turistik edhe për qytetarët e Drenasit dhe komunave përreth.

Me rreth 40 ha sipërfaqe totale, 11,430 m2 investime infrastrukturore, si dhe investimet pothuajse të përfunduara në infrastrukturën përcjellëse nga autoritetet komunale si shtigje për çiklisje e vrapim, pishat e Gllobarit pritet të jenë destinacioni i ri natyror i ecjes, piknikut, kampingut, relaksit, e qëndrimit ditor. Investimet private të cilat parashihen të ndodhin më pas do të jenë edhe një shtysë shtesë që ky vend të bëhet njëri nga atraksionet turistike në Kosovë.

**Liqet artificial te Vasilevës** gjinden rreth 3 km afër Parkut Industrial të formuar nga grumbullimi i dheut nga Korporata Energjetike e Kosovës në një teren piktoresk të rrethuar me pyje të ulëta ku ka mjaft shtazë të egra një vend atraktiv për zhvillimin e eko-turizmit me një sipërfaqen prej 176600m2.

**Uji i thartë në fshatin Poklek**, një burim natyror në largësi prej 2.5 km nga qyteti i Drenasit me një sipërfaqe prej 7278m2, uji i thart në fshatin Verboc me një sipërfaqe prej 182m2, vrella në fshatin Krajkov me një sipërfaqe prej 4000m2 si dhe vrella në fshatin Baicë me një sipërfaqe prej 3060m2.

### 6.9.2. Kultura dhe sporti

Këto vitet e fundit komuna ka qenë e përqendruar mjaft shumë në intensifikimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me aktivitetet rinore dhe sportive. Megjithatë buxheti shumë i vogël që ka komuna për këto aktivitete është faktorë mjaft kufizues. Buxhet maksimal nga komuna për OJQ është përafërsisht 123,000 Euro.

Në Komunën e Drenasit janë rreth 34 organizata të regjistruara si OJQ aktive , prej të cilave 4 prej tyre janë me aktivitete kulturore, 4 janë me aktivitete rinore, por nga to ka edhe individ që kryejnë aktivitete të ndryshme në këto fusha.

Palestra sportive e përzgjedhur edhe nga UEFA dhe që është në gjendje shumë te mire, që ka rreth 880 ulëse pastaj edhe sallat e tjera të sportit në shumicën e shkollave.

Ekipet e ndara si në futboll ashtu edhe në volejboll të kualifikuara, kanë mbështetje financiare si nga komuna por edhe donatorë të ndryshëm.

Numri i organizatave jo-qeveritare rinore, numri i shfaqjeve dhe përformancave artistike në shtëpinë e kulturës, numri i klubeve sportive sipas llojit të sportit, janë si në vijim;

**Tabela 9. OJQ-të Rinore**

| Nr | Emri OJQ - Klubit, Shoqatës | Vendi | Lloji i organizatës |
|---|---|---|---|
| 1 | KVRL- Këshilli i veprimit rinor lokalë Drenas | *Drenas* | Rinore |
| 2 | Liderët e së Ardhmes | *Drenas* | Rinore |
| 3 | Humanus Vita | *Drenas* | Rinore |
| 4 | OJQ CEDE – Qendra për Edukim dhe Zhvillim të Mjedisit | *Drenas* | Rinore |

Burimi: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

**Tabela 10. Aktivitetet e mbajtura në sallën e Kulturës**

| Numri i aktiviteteve | Vendi i mbajtjes se aktiviteteve | Viti | Lloji i aktiviteteve |
|---|---|---|---|
| 9 | Salla e Kulturës | *2024* | *Kulturore* |

**Tabela 11. OJQ-të - Klubet, Shoqatat Sportive të Regjistruara në MAP dhe DKRS - AKTIVE 2023**

| Nr | Emri OJQ - Klubit,Shoqatës | Vendi | Lloji i sportit |
|---|---|---|---|
| 1 | Football Club FERONIKELI 74 | Drenas | Futboll |
| 2 | Futsal Klub - LIQENI | Drenas | Futboll |
| 3 | New Stars Soccer School | Drenas | Futboll |
| 4 | Klubi Futsall " Drenasi" | Drenas | Futboll |
| 5 | Klubi i Futsall " Komorani" | Drenas | Futboll |
| 6 | Shoqata e të Shurëdhve Drenas | Drenas | Futboll |
| 7 | Klubi Futbollit - Ferinikeli (femrat) | Drenas | Futboll |
| 8 | Klubi i Futbollit "Yjet" | Drenas | Futboll |
| 9 | Klubi i Volejbollit- FERONIKELI (meshkujt) | Drenas | Volejboll |
| 10 | KLUBI VOLEJBOLLIT - GRYKA ( femrat) | Drenas | Volejboll |
| 11 | Klubi Volejbollit FERONIKELI - femrat | Drenas | Volejboll |
| 12 | Klubi i Hendbollit „DRENICA" | Drenas | Hendboll |
| 13 | Klubi i Pingpongut DRENASI | Drenas | PingPong |
| 14 | Klubi i Boksit DRENASI - Drenas | Drenas | Boks |
| 15 | Klubi motoristëve Motocross - DRENASI | Drenas | Motoristë |
| 16 | Klubi i Shenjë. dhe Shigjetarisë - QËNDRESA | Drenas | Shigjetari |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 17 | Klubi i Shigjetarisë - FERRONIKELI | Drenas | Shigjetari |
| 18 | Klubi i Shahut Drenasi | Drenas | Shah |
| 19 | Klubi i shahut te femrave te DRENASIT | Drenas | Shah |
| 20 | Klubi i Ngjitjes – KETRAT | Drenas | Ngjitje |
| 21 | Shoqata e Peshkatarve - DRENICA | Drenas | Peshkim |
| 22 | Klubi i Shenjëtarisë BESIM MALA - MURRIZI | Drenas | Shenjtari |
| 23 | Auto Moto Karting Klubi - DRENICA Racing | Drenas | Automoto |
| 24 | Shoqata e Pedagogëve e sportit shkollor të Kulturës Fizike – Komunale,Regjionale, Republikane | Drenas | Të gjitha plasmanet |
| 25 | Shoqata e Veteranëve të Edukimit Fizik dhe Sportit | Drenas | Shpend Bogiqi |
| 26 | Klubi Notit - DREFINA | Drenas | Ekrem Mehmeti |

Janë gjithsejtë katër Biblioteka të cilat kanë nevojë për investime në infrastrukturë fizike.

Qendra Rinore është pasive edhe pse është në infrastrukture të mirë. Salla e kulturës është funksionale por me infrastrukture minimale për funksion.

Asnjë aktivitet kulturor nuk është i digjitalizuar, andaj planifikohet që në sallën e re të kulturës të jetë çdo gjë e digjitalizuar.

Sa i përket panaireve dhe festivaleve të ndryshme janë si në vijim:

Tabela 12. Panairet dhe festivalet tradicionale

| | Aktivitetet Kulturore, Sportive dhe Rinore |
|---|---|
| - | Aktiviteti festiv për nderë të 17 shkurtit mbahet dhe ka program të gjatë festiv; |
| - | 17 Prilli aktiviteti " Sofra Poetike Ymer Elshani" mbahet ç'do vit; |
| - | 14 Qershori aktivitete kulturore, Sportive për nderë të Ditës së Çlirimit të Drenasit; |
| - | Aktiviteti Ditët e Mërgatës gjatë muajit Korrik - Gusht që përkrahet edhe nga Komuna përmes Subvencioneve. |
| - | Revista Realiteti i organizatave rinore nuk është aktive më; |
| - | Kongresi i Manastirit po, qe mbahet nga data 16 deri 22 Nëntor; |
| - | Mbajtja e festivalit të grupeve kulturo-artistike të shkollave fillore me karakter garues |
| - | Aktivitete për nder të festave të Nëntorit |
| - | Humoriada dhe Folklori nuk janë me aktive; |
| - | Aktiviteti i organizuar nga OJQ "Art Club Rifat Kukaj" aktivitete të orës letrare të mbajtura të Guri i Plakës me poet nga Diaspora dhe vendi. |
| - | 14 shtator organizimi i Muajit të Rinisë i cili organizohet nga sektori i Rinisë në bashkëpunim me OJQ-të Rinore |

| | |
|---|---|
| - | Aktivitete rinore për nderë të mjedisit, ambientit, Tokës etj. |
| - | Garat komunale të shkollave në të gjitha plasmanët në nivel komunal të organizuara nga DKRS dhe DKA |

Burimi: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Planifikohet të ndërtohet pra salla e kulturës që i mbulon të gjitha aktivitetet kulturore, dhe krijon kushte të favorshme për të gjitha këto aktivitete.

Muzeu etnokulturor është aktiv dhe pasurimi i tij me fakte tjera dhe rritja e numrit të vizitorëve në të do të jetë ndër objektivat kryesor për vitet

### 6.9.3. Rinia

Të rinjtë e Drenasit, si në shumë komuna të tjera në Kosovë, përballen me një gamë të sfidave të ndryshme që ndikojnë në zhvillimin e tyre personal, profesional dhe social. Këto sfida, ndonëse të ndryshme në natyrë, shpesh kanë rrënjë të përbashkëta me ato të hasura në shumë vende të tjera.

Komuna është e angazhuar për krijimin e një ambienti përkrahës dhe të pranueshëm thelbësor për të adresuar këto probleme. Përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse, ndonëse ka mjaft përparime, ende mbetet një sfidë. Është e nevojshme të ndërtohen platforma dhe të krijohen mundësi për përfshirje aktive të rinjve në diskutime dhe vendime që i prekin ata direkt.

Përballja me këto sfida kërkon angazhim të përbashkët nga qeveria, sektori privat, organizatat joqeveritare dhe komuniteti në përgjithësi. Është jetike që të adresohen këto sfida për të ndihmuar të rinjtë të zhvillohen në të gjitha aspektet e jetës së tyre. Kjo përfshirje do të ndërtojë një mjedis më të mirë për të ardhmen e tyre dhe do të sigurojë një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe demokratike.

## 6.10. SWOT analiza

| Përparësitë | Dobësitë |
|---|---|
| ➢ Pozicioni gjeografik<br>➢ Burime natyrore<br>➢ Trashëgimia kulturore<br>➢ Popullsia e re<br>➢ Mjedis miqësor për biznese | ➢ Infrastrukturë publike jo e mirë (sidomos ujësjellësi, kanalizimi)<br>➢ Papunësia<br>➢ Orientimi i bizneseve nga shërbimet, shumë pak nga prodhimi<br>➢ Menaxhimi jo i mirë i resurseve natyrore të tokës dhe sistemeve të ujijes<br>➢ Koncentrimi i bizneseve vetëm në zona urbane (Gllogoc, Komoran)<br>➢ Buxheti i vogël i komunës |
| **Rreziqet** | **Mundësitë** |
| ➢ Emigrimi (posaçërisht i të rinjve, jashtë vendit dhe në qendra të mëdha)<br>➢ Konkurrenca Rajonale<br>➢ Degradimi i Mjedisit<br>➢ Ndryshimet në Politikat e Zhvillimit në nivel vendi<br>➢ Burime të kufizuara financiare për projekte kapitale | ➢ Zhvillimi Ekonomik<br>➢ Infrastruktura Moderne<br>➢ Turizmi dhe trashëgimia kulturore<br>➢ Edukimi dhe Trajnimi.<br>➢ Bashkëpunimi nder komunal (në projekte të përbashkëta) |

## 6.11. Analiza e situatës

Pema e Problemit për Komunën e Drenasit (efektet) paraqet një analizë të detajuar të problemeve kryesore me të cilat përballet komuna, duke e ndarë problemin kryesor në degëzime që pasqyrojnë shkaqet dhe pasojat e tij. Në këtë rast, mund të përqendrohemi te sfidat ekonomike, infrastrukturore, shoqërore dhe mjedisore që ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës. Këtu do të fokusohemi te efektet, pra te pasojat që ndodhin si rezultat i problemeve të theksuara në zonën e Drenasit.

Efektet (pasojat) e këtyre problemeve mund të përmblidhen si në vijim:

**Ekonomia lokale dhe punësimi,** Komuna e Drenasit ka qenë mjaft aktive për krijimin e një ambienti miqësor me bizneset, megjithatë ka ende familje që përballen me të ardhura të pamjaftueshme që kufizon mundësitë për investime në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie.

Migrimi i të rinjve, në qendrat urbane dhe jashtë vendit, për shkak të mundësive ekonomike më të mira për jetesë dhe punësim, në qytete të mëdha ose jashtë vendit. Kjo situatë prodhon zvogëlim të fuqisë punëtore lokale si dhe reduktimi i punëtorëve të kualifikuar dhe i fuqisë punëtore për industrinë dhe bujqësinë lokale.

Mungesa e investimeve (qoftë nga niveli qendror, apo investitorë tjerë), në zhvillimin e sektorëve kyç dhe zhvillim të qëndrueshëm, bën që sektorët kyç si bujqësia dhe industria të mos arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Bizneset dhe fermerët lokalë përballen me mungesë inovacioni dhe teknologji të avancuara, duke u kufizuar në mundësitë për rritje të qëndrueshme.

Vërehet varësi e madhe nga asistenca sociale që për rezultat ka mundësi të vogla për zhvillim ekonomik dhe përmirësim të kushteve të jetesës. Shumë familje varen nga skemat e asistencës sociale, duke rënduar sistemin financiar të komunës dhe duke krijuar një cikël varësie.

**Arsimi,** Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar në Komunën e Drenasit 2024/25 - 2028/29, tregon për rëndësinë dhe angazhimin e komunës për ti adresuar problemet dhe prioritetet e zhvillimit të këtij sektori për 5 vitet e ardhshme.

**Cilësia e jetesës,** Megjithëse në Infrastrukturën rrugore është bërë shumë punë, në pjesën tjetër të infrastrukturës (posaçërisht ujësjellësi, kanalizim, energji elektrike,) ka ende shumë punë për të bërë, në mënyrë që të eliminohen këto vështirësi të cilat krijojnë probleme, e të cilat ndikojnë negativisht në standardin e jetesës së banorëve.

**Qasja në shërbime shëndetësore**: Për shkak të numrit të madh të vizitave mjekësore, qytetarët përballen me vështirësi në qasjen e shërbimeve shëndetësore cilësore.

**Rritje e ndotjes dhe degradimit të mjedisit** si dhe menaxhimi i dobët i mbetjeve, ndotja e ajrit dhe ujit si dhe shfrytëzimi jo i duhur i tokave. Të gjitha këto përkeqësojnë cilësinë e mjedisit dhe ndikojnë negativisht në shëndetin e komunitetit.

Këto efekte përfaqësojnë një rrjedhojë direkte të problemeve ekzistuese në komunën e Drenasit dhe nënvizojnë nevojën për një qasje të gjithanshme dhe strategjike për të përmirësuar gjendjen ekonomike, sociale dhe infrastrukturore të komunës.

### 6.12. Përmbledhja e sfidave

Komuna e Drenasit përballet me një sërë sfidash ekonomike, sociale, arsimore dhe infrastrukturore. Ekonomia përballet me probleme të investimeve dhe teknologjive të vjetruara, ndërsa papunësia dhe varfëria ndikojnë në mirëqenien sociale. Sistemi i arsimit ka nevojë për përmirësime të dukshme në infrastrukturë (laboratorë, kabinete) dhe cilësi, ndërsa shërbimet publike dhe infrastruktura (posaçërisht në pjesën e ujësjellësit dhe kanalizimit) kërkojnë investime të konsiderueshme për të përmbushur nevojat e qytetarëve.

Mungesa e investimeve në sektorë të rinj dhe mungesa e diversifikimit të ekonomisë mund të ndikojnë në varësinë nga disa sektorë tradicionalë, si bujqësia.

Edhe pse komuna e Drenasit njihet si njëra nga komunat që në nivel të administratës ka avancuar shume në barazinë gjinore, dhe më transparente gratë në komunë ende përballen me pengesa për integrimin e plotë në tregun e punës dhe kanë qasje të kufizuar në burime dhe shërbime.

#### 6.12.1. Sfidat në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Sektori i bujqësisë në Komunën e Drenasit përballet me sfida të ndryshme që kufizojnë zhvillimin dhe rritjen e këtij sektori

Përdorimi i teknikave tradicionale të bujqësisë dhe pajisje të vjetra, shpesh çon në efikasitet të ulët dhe prodhimtari të kufizuar. Nevojiten investime në mekanizim modern dhe pajisje teknologjike që do të ndihmonin në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së prodhimit bujqësor.

Ujitja është një problem i madh për fermerët në Drenas, pasi një pjesë e madhe e tokave bujqësore mbështetet vetëm në reshjet e shiut, duke e bërë prodhimin bujqësor të varur nga kushtet klimatike. Ky problem është mjaft specifik për këtë komunë pasi që nuk shfrytëzohen madje as sistemet ekzistuese të ujitjes, si dhe po thuajse nuk ka fare investime në këtë fushë.

Shumica e fermerëve posedojnë parcela të vogla dhe të fragmentuara, gjë që e bën të vështirë implementimin e metodave më të avancuara të bujqësisë dhe krijon vështirësi

në mekanizimin e plotë të fermave. Për shkak të kufizimeve ligjore dhe kadastrave të vjetra, është e vështirë për fermerët të bashkojnë ose të blejnë toka shtesë për të zgjeruar operacionet e tyre. Komasacioni i ndërprerë (i filluar shumë dekada më herët), shkakton shumë probleme tek pronarët e tokave që janë të përfshira në këtë proces.

Fermerët shpesh përballen me vështirësi për të shitur prodhimet e tyre për shkak të qasjes së kufizuar në tregjet lokale dhe kombëtare.

Gjithashtu fermerët përballen me konkurrencë të lartë dhe shpesh janë të detyruar të shesin produktet e tyre me çmime të ulëta, duke ulur përfitimet e tyre financiare.

Ndryshimet klimatike kanë sjellë rritje të temperaturave dhe mot të paparashikueshëm, duke ndikuar në ciklet e prodhimit bujqësor dhe rrezikun nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Fermerët në këtë komunë (sikurse edhe në gjithë Kosovën), kanë pak njohuri për pasojat që sjellin këto ndryshime, dhe mënyrën e përballjes me pasojat e këtyre ndryshimeve.

Fermerët kanë vështirësi të ruajnë produktet e tyre për periudha më të gjata për shkak të mungesës së objekteve (qendrave grumbulluese, depove, etj) të ruajtjes me temperaturë të kontrolluar dhe teknologjive për ruajtje.

Këto sfida kërkojnë një qasje të gjithanshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Drenas, duke përfshirë investime në infrastrukturë, mekanizim, trajnime për fermerët dhe një strategji më të mirë për qasjen në tregje dhe rritjen e kapacitetit prodhues.

**6.12.2. Sfidat në sektorin e Arsimit**

Zhvillimet demografike tregojnë një rënje të lartë në popullatën e re, për shkak të rënies së vazhdueshme të lindjeve dhe shkak të emigrimit të të rinjve dhe familjeve të reja.

Komuna e Drenasit gjegjësisht DKA ka vendosur fokus strategjik për përmirësimin e rëndësisë së programeve të shkollave sipas nevojës së tregut të punës në harmonizim me Kornizen Kurrikulare të Kosovës dhe të ofroj sistematikisht përvojë pune dhe praktikë profesionale në cilësin më të lartë.

Ndarja e buxhetit për kategoritë ekonomike, mallra dhe shërbime, shërbime komunale dhe kapitale të vogla për kokë nxënësi janë tepër të vogla, të papërballueshme për koston vjetore të shkollave sipas formulues së financimit , e cila duhet të ndryshoj në aspektin e rritjes të grantit specifik për Arsim.

### 6.12.3. Sfidat në sektorin e Infrastrukturës

Edhe pse në vitet e fundit ka pasur përmirësime në infrastrukturë (sidomos në infrastrukturën rrugore) megjithatë, sektori i infrastrukturës në komunën e Drenasit përballet me një sërë sfidash që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së banorëve.

Mbulimi i të gjitha fshatrave me ujësjellës është njëra nga sfidat për infrastrukturën e komunës së Drenasit. Infrastruktura e dobët për furnizimin me ujë: Rrjeti i ujësjellësit është i vjetër dhe shpesh ka rrjedhje apo probleme të tjera teknike (humbjet e mëdha deri 50 %).

Shumë pjesë të qytetit dhe fshatrat kanë sisteme të kanalizimeve të vjetërsuara ose të paplota, duke krijuar rrezik për ndotjen e mjedisit dhe shëndetin publik, veçanërisht gjatë shirave të mëdha.

### 6.12.4. Sfidat në sektorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:

Sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në Komunën e Drenasit përballet me një sërë sfidash që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për qytetarët.

Disa qendra shëndetësore në komunë janë të vjetërsuara dhe nuk përmbushin standardet bashkëkohore të ofrimit të shërbimeve shëndetësore. Nga të gjitha institucionet në komunë, shtatë funksionojnë pjesërisht sepse mungon qoftë ndonjë pajisje mjekësore apo edhe ndonjë nga inventari.

Shumë prej institucioneve shëndetësore nuk janë të pajisura me teknologji dhe pajisje moderne, duke e bërë të vështirë për profesionistët shëndetësorë të ofrojnë kujdes cilësor.

Pavarësisht shtrirjes së madhe të rjetit të institucioneve shëndetësore, numri i vizitave në QKMF vazhdon të mbetet i lartë. Në vitin 2023 numri i vizitave 190,578, numri i shërbimeve 353,233, pra totali i vizitave dhe shërbimeve ka qenë 543,811. Në 6 mujorin e vitit 2024 kanë qenë 85,983 vizita, 191,625 shërbime, gjithesej numri i vizitave dhe shërbimeve 277,608.

Financimi për shërbimet shëndetësore është i kufizuar, gjë që ndikon në ofrimin e barnave, pajisjeve mjekësore dhe përmirësimin e kushteve në qendrat shëndetësore.

Komuna shpesh përballet me mungesë të burimeve për të ofruar shërbime të specializuara, si trajtimet për sëmundje kronike, kujdesin dhe shërbimet për shëndetin mendor.

Është e nevojshme që të ketë mbështetje më të mirë për personat që përballen me çrregullime të shëndetit mendor. Shërbimet e psikologjisë dhe psikiatrisë janë të kufizuara dhe nuk janë të arritshme për shumicën e banorëve.

